

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË  
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY  
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА

STUDIME POSDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEMA: “PABARAZIA DHE RITJA EKONOMIKE NË VENDET  
E TRANZICIONIT”

Kandidati: Linda Fetai

Mentor: Asoc.Dr. Selajdin Abduli

Tetovë, 2020

## **Mirënjohje**

Mirënjohjet më të mëdha shkojnë për të gjithë ata që kontribuan gjatë përgaditjes së këtij hulumtimi, ku mirënjohja ime më e madhe i drejtohet mentorit tim Soc.Dr Selajdin Abuli që më dha përkrahje tejet të madhe gjithashtu që asnjëherë s'ka kursyer kohë për të më ndihmuar, sugjeruar, motivuar dhe rekomanduar përgjat gjithë punës sime.

Falemenderimet e mia më të sinqerta i drejtohen edhe anëtarëve të komisionit Asoc.Dr Shpresa Syla dhe Dr.Sadudin Ibraimi që kontribuan në përkrahjen time për të arritur deri këtu.

Falemenderimet e mijja më të përzemërta i takojnë edhe familjes sime, në veçanti prindërve të mi, ku pa përkrahjen e tyre nuk do të isha këtu, më shumë që më motivoi shpirtërisht, padyshim mbetet biri im, që ka qenë prezent gjat gjithë punës sime.

## **Abstrakti**

Objektivi kryesor i këtij punimi është që të investigojmë në mënyrë empirike ndikimin e pabarazisë ekonomike në rritjen ekonomike si dhe determinantat e saja, në vendet në tranzicion si (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Hungari, Estoni, Republik Çeke, Poloni, Rusi dhe Maqedonin e Veriut), gjatë periudhës kohore 2009-2018. Ky hulumtim është kryer me metoda të sofistikuar ekonometrike si të tilla: OLS me gabim standard të besueshem, qasjen e efekteve të rastësishme dhe fikse si dhe Hausman-Taylor modelin me variablat instrumentale (IV). Rezultatet e këtij hulumtimi empirik nxjerrin në pah dy çështje e para, se ulja e pabarazisë ekonomike ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike, dhe e dyta, se subvencionet dhe transferat ndikojnë pozitivisht në uljen e pabarazisë dhe si rjedhim në rritjen ekonomike në vendet në tranzicion. Ky punim do të shërbej Qeverive të vendeve në tranzicion si evidence empirike që të ndërmarin masa, në kuadër të implikimeve politike, për uljen e pabarazisë e cila do të çon në rritjen ekonomike dhe si rjedhim në një mirëqenje më të lartë të vendeve në fjalë. Si çdo punim tjetër edhe ky punim i ka limitimet e veta, ku duhet të inkudarohen edhe ca variabla tjera kontrolluese në funksion të rrijës së performances së modelit dhe besueshmërisë së rezultateve.

Fjalët kyçe: Vendet në tranzicion, indeksi i Gin-it, norma e rritjes ekonomike, subvencionet dhe transferat.

## **Абстракт**

Главната цел на овој труд е да се истражува емпирички влијанијето на економска нееднаквост и нејзините детерминанти во земјите во транзиција (Албанија, Косово, Србија, Хунгарска, Естонија, Чешка, Полска, Русија и Република Северна Македонија), во периодот 2009-2018. Овај труд е реализиран со софистицирани економетриски методи како што се ОЛС, фиксниот и случајниот пристап и Хаусман-Таслор моделот со инструментални вариабли (IV). Резултатите од емпириско истражување покажуваат дека намалувањето на економска нееднаквост вилјае позитивно врз економскиот раст и субвенциите и трансферите влијат позитивно брз намалувањето на економската нееднаквост и следствено на тоа врз зголемување на економскиот раст во земјите во транзиција. Овој труд ќе им служи на Владите во земјите во транзиција како емпиричка евиденција за да преземат соодветни мерки, во нивните политики, за намалување на економската нееднаквост која треба да води до

зголемување на економскиот раст и благосостојбата како целина. Како секој труд и овој има својите слабости каде што треба да се вклучуваат и други вариабли во моделот во функција на зголемување на перформанцата на моделот и веродостојноста на резултатите.

Глави зборови: Економски раст, индекс на цин, субвенции и трансфери.

### **Abstract**

The main objective of this research is to investigate the impact of economic inequality and economic growth, and its determinants in the transition countries (Albania, Kosovo, Serbia, Hungary, Estonia, Check Republic, Polonia, Russia, and Republic of North Macedonia) during the period 2009-2018. For this purpose, we employed sophisticated econometrics methodology such as: OLS with robust standard error, Fixed and Random approach and Hausman-Taylor approach instrumental (IV). Findings of this empirical research highlights two issues: first, the decrease of the economic inequality has a positive effect on economic growth and second, subvention and transfers have a positive effect on reducing the economic-inequality, which in turn lead to an increase of the economic growth in the transition countries. The thesis provides useful empirical evidence for the Government of the transition countries, to take action in their, policy implication, in order to reduce economic inequality, which may generate a positive effect on economic growth and thus to welfare benefit. The limitation of this study contains lack of some significant variables in the model, which should be included in the empirical model in the further research.

Keywords: Transition economies, Gin index, economic growth, subsidies and transfers.

## PËRMBAJTJA

Abstrakti.....	3
Абстракт .....	3
Abstract.....	4
1. HYRJE.....	7
2. RITJA EKONOMIKE DHE NË VENDET E TRANZICIONIT .....	8
2.1 RITJA EKONOMIKE DHE DETERMINATAT E SAJA .....	8
2.2 DETERMINANTAT E RITJES EKONOMIKE.....	9
2.2.1 GIN-index .....	9
2.2.2 Indeksi i Korrupsionit .....	10
2.2.3 Subvencionet dhe transferat .....	12
2.2.4 Shpenzimet qeveritare.....	13
2.2.5 Te ardhurat publike.....	15
2.2.6 Indeksi i cmimeve të konsumit .....	16
3. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	17
3.1 ASPEKTI TEORIK.....	17
3.1.1 Teoria neoklasike .....	18
3.1.2 Teoria Neokejnziane .....	19
3.2 Evidenca empirike .....	20
4. METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT .....	24
4.1 METODOLOGJIA .....	24
4.2 SPECIFIKIMI I MODELIT TË REGRESIONIT TE THJESHTE LINEAR.....	25
4.3 METODA E VLERSIMIT TË KATRORËVE TË VEGJËL (OLS).....	25
4.4 MODELI FIXED EFFECTS DHE RANDOM EFFECTS .....	26
4.5 MODELI FIXED EFFECTS.....	27
4.6 MODELI RANDOM EFFECTS.....	28
4.7 HAUSMAN TAYLOR IV .....	30
4.8 DALLIMI I MODELEVE FIXED EFFECTS , RANDOM EFFECTS, HAUSMAN TAYLOR.....	31
4.9 MODELI EMPIRIK.....	32
5. TESTIMI I DETERMINANTAVE TË GIN INDEXIT DHE RITJES EKONOMIKE.....	33

5.1 INTERPRETIMI I REZULTATEVE .....	34
6. PËRFUNDIMI .....	37
7. LITERATURA- REFERENCAT .....	39
7.1 LLOGARITJA NE APPENDIX .....	44
Appendix.A.....	44
7.2 Appendix B. ....	45

### **Lista e figurave:**

Grafikoni 2.1 GDP per capita në vendet e tranzicionit periudha 2009-2018.....	8
Grafikoni 2.2 GIN index në vendet e tranzicionit.....	10
Grafikoni 2.3 Indeksi i korrupsionit në vendet e tranzicionit.....	11
Grafikoni 2.4 Subvencionet dhe transferet.....	12
Grafikoni 2.5 Shpenzimet qeveritare .....	14
Grafikoni 2.6 Te ardhurat publike .....	15
Grafikoni 2.7 Indeksi i çmimeve të konsumit.....	16

### **Lista e tabelave:**

Tabela 2.1 GDP per capita në vendet e tranzicionit periudha 2009-2018.....	9
Tabela 5.1 Testimi i determinantave të Gin index në vendet e tranzicionit.....	34
Tabela 5.2 Testimi i determinantave të rritjes ekonomike në vendet e tranzicionit.....	35
Tabela A1. Vendet e përfshira në modelin empirik .....	44
Tabela A2. Përshkrimi i Variablave .....	44

## 1. HYRJJE

Ky hulumtim shkencor egzaminon në mënyre empirike ndikimin e pabarazisë ekonomike në rritjen ekonomike si dhe determinantat saja, në periudhe kohore nga viti 2009-2018, në vendet në tranzicionit. Një pjesë e madhe e evidencës empirike tregon se pabarazia ekonomike ndikon negativisht në rritjen ekonomike, më konkretisht, me një kauzalitet negativ njëra me tjetrën, ku çdo rritje e pabarazise ndikon në uljen e rritjes ekonomike dhe e kundërta. Në anën tjetër ka autorë që e dëshmojnë të kundërtën se pabarazia ekonomike nuk ndikon negativisht në rritjen ekonomike. Andaj për këtë çështje nuk ka koncensus në mes autorëve të ndryshëm se pabarazia ekonomike ka apo nuk ka ndikim në rritjen ekonomike. Ky është edhe motovimi im kryesor që sadopak të jap një kontribut shkencor në lidhje mbi ndikimin e pabarazisë ekonomike në rritjen ekonomike në vendet në tranzicion. Andaj qëllimi kryesor i këtij punimi është të invesigojë ndikimin e pabarazisë ekonomike në rritjen ekonomike dhe determinantat e saja në vendet në fjalë. Për këtë qëllim unë kam ngritur dy pyetjet hulumtuese dhe dy hipotezat, ku me metoda të sofistikuara ekonometrike të verifikoj pohimin ose mohimin e validitetit të tyre. Pyetja e parë hulumtuese është se reduktimi i pabarazisë a ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike? Dhe pyetja e dytë hulumtuese është se subvencionet dhe transferat a ndikojnë pozitivisht në uljen e Gin-indexit-si- matës i pabarazisë ekonomike? Shumica e autorëve kanë përdorur Gin-indeksin si variabël për matjen e pabarazisë ekonomike, kurse krahas kësaj si determinanta kryesore që ndikojnë në Gin-indeksin janë inkuadruar, subvencionet dhe transferat si dhe variabla kontrolluese siç janë shpenzimet qeveritare, indeksi i korrupsionit, të ardhurat publike, dhe indeksi i çmimeve të konsumit ose inflacioni.

Në vazhdim për t'ju dhënë përgjigje pyetjeve hulumtuese të ngritura më lartë ne parashtrojmë hipotezat në vijim.

### **Hipotezat:**

**H1/1: Reduktimi i pabarazisë ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike**

**H1/2: Subvencionet dhe transferat ndikojnë pozitivisht në uljen e GIN – indexit.**

Për të kontrolluar validitetin e hipotezave unë kam shfrytëzuar metoda të sofistifikuara ekonometrike si OLS me standard të besueshëm dhe panel metodat siç janë: qasja fikse, qasja e rastësishme dhe qasja e Hausman Taylor IV. Kontributi i këtij punimi qëndron në faktin se





### Burimi: Kalkulim nga autori

Në bazë të të dhënave reale, Estonia arrinë me vlera më të larta negative të GDP-së për kokë banori me vlerën prej -14.26 % por shumë shpejtë arriti që të stabilizojë këtë normë në vitin 2010 ku norma vjetore e rritjes ekonomike shënoi 2.94 %, edhe Rusia gjatë recesionit që ndodhi në mbarë botën arrinë vlera negative në vitin 2009, me një vlerë prej -7.82 %.

*Tabela 2.1 GDP per capita në vendet e tranzicionit periudha 2009-2018*

	Shqipëri	Macedonia e V.	Sërbia	Kosova	Polonia	Republika Ceke	Hungaria	Estonia	Rusia
<b>2009</b>	4.04	-0.44	-2.34	2.76	2.75	-5.34	-6.55	-14.26	-7.82
<b>2010</b>	4.22	3.27	1.13	2.48	3.90	1.97	0.89	2.94	4.45
<b>2011</b>	2.82	2.25	2.84	3.48	4.90	1.56	2.10	7.76	4.21
<b>2012</b>	1.58	-0.54	-0.19	2.001	1.60	-0.93	-0.96	3.48	3.52
<b>2013</b>	1.18	2.83	3.39	2.37	1.45	-0.51	2.24	1.70	1.58
<b>2014</b>	1.98	3.54	-1.12	1.35	3.39	2.60	4.47	3.25	-1.08
<b>2015</b>	2.51	3.77	2.28	5.25	3.90	5.10	4.09	1.77	-2.51
<b>2016</b>	3.48	2.77	3.88	3.24	3.10	2.25	2.50	2.60	0.15
<b>2017</b>	3.91	0.18	2.59	3.4	4.90	4.07	4.60	5.60	1.51
<b>2018</b>	4.403	2.61	4.97	2.9	5.13	2.65	5.30	4.48	2.26

### Burimi: IMF dhe Banka Botrore

Rritja vjetore ekonomike e vitit 2012 ka pasur norma të ulta ekonomike e gjithë kjo si rezultat rritjes së borxhit publik, gjat këtij viti kemi pasur rritje të vogël të pagave, e cila ka ndikuar në rritjen e çmimeve, ku disa vende kanë arritur që të stabilizojnë vlerat e PBB-së për kokë banori në vitin 2013, ndërsa Shqipëria ka shënuar rritje të ngadaltë ekonomike, ku në vitin e fundit arrinë normën më të lartë prej 4.4 %.

## 2.2 DETERMINANTAT E RITJES EKONOMIKE

### 2.2.1 GIN-index


Gin index është determinantë që mat pabarazinë midis (të ardhurave, apo shpërndarjen e pasurisë), kryesisht marrëdhënia midis pabarazisë së të ardhurave dhe rritjes ekonomike ka marrë shumë vëmendje në literaturën ekonomike. Bazuar në të dhënat e përdorura, shohim se ekonomitë në tranzicion të Evropës Lindore dhe ish-Bashkimit Sovjetik pësuan një rritje dramatike të pabarazisë së të ardhurave në vitet 1990. Marrëdhënia midis pabarazisë së të

ardhurave, e matur nga koeficienti Gini, dhe PBB për frymë tregohet të jetë pozitive për Evropën Lindore dhe negative për ish-Bashkimin Sovjetik.

Në grafikon shohim që Maqedonia e Veriut rrezultone me një rritje pozitive të vazhdueshme të pabarazisë duke filluar nga një shpërndarje mjaft të pabarabartë në të ardhurat, kryesisht duhet patjetër të zbatohen politika për të zvogluar pabarazinë, si fillim duhet një ridizajnim i sistemit për mbrojtjen sociale, që ndihmat sociale të ndahen për ata që kanë nevojë, së dyti duhet të rriten të mirat publike si shëndetësia dhe arsimi si dhe konsumi i shtuar mos shkojë vetëm në import por të realizohen prodhime më të mëdhaja në vend.

Republika Çeke arrinë norma më të qëndrueshme dhe më të ulta në krahasim me vendet tjera, gjithashtu edhe në Poloni rritja e pabarazise ka qenë e qëndrueshme dhe pasqyron ndryshime më të mëdha në punësim në krahasim me vendet tjera. Pabarazia në Shqipëri është ulur përgjatë dekadës së fundit, në bazë koeficientit Gin që mat indeksin e pabarazisë, kryesisht shpërndarja e pabarabartë e pasurisë siç tregohet nga koeficienti Gini ka tendencë të uljes në vitet e fundit, më pas rradhitet Hungaria e cila arrinë normë më të lartë në vitin 2017 prej 30.15%.

*Grafikoni 2.2 GIN index nëvendet e tranzicionit*



Burimi: Kalkulim nga autori


### 2.2.2 Indeksi i Korrupsionit

Ekonomistët dhe shumë studiues kanë parë një interes tejet të madh në studimin e fenomenit të korrupsionit dhe se si ndikon ai në ekonominë e vendit dhe se sa shoqëria përjeton pasoja nga korrupsioni. Korrupsioni tashmë është rritur shumë qoftë në ekonomitë në zhvillim dhe

në ato të zhvilluara, në të cilën ka impakt negative si në atë ekonomik ashtu edhe në atë social.

Ne bazë të raportimeve të institucioneve ndërkombëtare siç janë institucionet e Bankes Boterore dhe BE-së kanë konstatuar se korrupsioni i zvogëlon të ardhurat shtetërore dhe nga ana tjetër rriten shpenzimet publike, ku kjo ka impakt në bilancin e defiçitit të pagesave, duke penguar baraspeshimin e tyre. Korrupsioni është gangrene ku mund të bëj shtetin inekzistent, ku qeveritë duhet të luftojnë korrupsionin me të gjitha mekanizmat e duhura.

**Grafikoni 2.3 Indeksi i korrupsionit në vendet e tranzicionit**



**Burimi: Kalkulim nga autori**

Korrupsioni gjatë vitit 2009 në Sërbi ka qenë 3% e cila arrinë një normë më të ulët në të gjithë vendet e tranzicionit, kjo normë nuk zgjati shumë ku një vit më vonë arriti që të shumfishojë vlerën e saj në 34%, kjo normë e lartë vazhdoi deri në vitin 2018 ku u ndoq me një normë më të lartë në 40%.

Vendi që është dalë nga një diktaturë është Shqipëria. në të cilën korrupsioni bëhet nga ana e individëve të cilët janë në pushte, ky vend gjithashtu mbetet peng i investimeve të huaja direkte, ku investimet janë elementi thelbësor i një shteti për të qenë i fuqishëm. Në grafikon shohim që rritja e normës së korrupsionit më e madhe ka qenë në tre vitet e fundit me një normë prej 36%.

Vendi që rradhitet me norma më të ulta në krahasim me vendet tjera është Rusia, ku norma më e ulët e saj ishte në vitin 2013 me 21% ndërsa normë më të lartë realizoi në vitin 2018 me 29%. Vendi që ka tendencë më të lartë në grafikon është Estonia, vlerat e saja kanë qenë më të larta nga të gjithë vendet tjera të perfshirë në grafikon, vlerat e saj kanë qenë të

vazhdueshme përgjatë dhjetë vitet e fundit, por vlera e saj më e lartë arriti në vitin 2018 me një normë prej 70% të indeksit të korrupsionit. Gjithashtu në bazë mungesës së të dhënave në Kosovë, indeksi i korrupsionit arriti vlerën më të lartë në vitin e fundit me një mesatare prej 33%, krahas kësaj edhe Polonia e dyfishoi vlerën e saj nga 37% të vitit 2009, ku në vitin e fundit indeksi i korrupsionit arriti normën në 62%.


Sic ilustruhet në (Grafikonin 2.3) shihet se ekziston një pabarazi e madhe midis vendeve të tranzicionit, ku disa nga këto vende ka një përhapje më të vogël të korrupsionit, ndërsa disa prej tyre një përhapje më të lartë, duke filluar nga një mesatare 3% të korrupsionit në Sërbi deri me një mesatare më të lartë në 70% në Estoni.

### 2.2.3 Subvencionet dhe transferat

Kemi lloje të ndryshme të subvencioneve, si subvencionet e punës, mbrojtjes së tregut, furnizuese, infrastrukturë, konsumit, indirekte etj. Sa u përket subvencioneve eksportuese këto përdoren në disa vende, ku masa të tjera mbështetëse të tregut (si çmime të mbikqyrura, intervenim në treg) janë in-ekzistente apo më pak të rëndësishme.

Në dhjetë vitet e fundit, në shumicën e vendeve të tranzicionit kemi pasur ndryshime në politikën agrare, gjithashtu edhe transferat buxhetore në bujqësi kanë shënuar një rritje rapide, në Sërbi dhe Shqipëri transferat kanë qenë fluktuive. Shumë studjues të rritjes ekonomike si (Barro, 1997), sa u përket transfertave sociale i konsideron si joproduktive, ku shfrytëzuesit i shpenzojnë për konsum të përditshëm dhe në këtë rast e impaktojnë kërkesën agregate dhe kanë ndikim në rritjen ekonomike.

**Grafikoni 2.4 Subvencionet dhe transferet**



Burimi: Kalkulim nga autori

Në bazë statistiakave që shohim, konstatojmë se gati të gjitha vendet e tranzicionit, japin një kontribut të rëndësishëm në aspektin e subvencioneve. Po të shohim të dhënat statistikore nga të gjithë vendet tjera, vetëm Kosova arrinë normën më të ulët për mbështetjen financiare nga qeveria, ndërsa vendet tjera shënojnë përmisimin më të madh në vitet e fundit.

Qeveria e Maqedonise së Veriut ndanë shumë herë mjete financiare për mbështetjen e sektorit bujqësor duke bërë krahasimin me vitet e kaluara, siç e shohim në grafikun ka patur një trend të rritjes në vitet e fundit. Shqipëria ka shënuar një rritje konstante gjatë viteve që janë paraqitur në grafikun ndërsa Republika Çeke arrinë norma më të larta në krahasim me vendet tjera të tranzicionit, norma më e lartë arrinë në vitin 2015 me 76.67 %.

E rëndësishme është që shumica e vendeve kanë arritur norma pozitive, po ekziston nevoja për angazhim më të madh në përmisimin dhe krijimin e kushteve më të mira në sektorin agrar drejt rrugës për në Unionin Evropian.

#### **2.2.4 Shpenzimet qeveritare**

Sot qëllimi i studimit të shpenzimeve publike qëndron, para se gjithash, në karakterin dhe ndikimin e tyre në ekonomi, përkatesisht gjithnjë e më shumë në aspektin e tyre cilësor, përkundër aspektit sasior. Pjesën më të madhe të mjeteve, të cilat sot i shpenzon shteti për realizimin e qëllimeve të caktuara socio-ekonomike të zhvillimit, nuk dështojnë, përkatesisht nuk zhduken në pakthim. Shpenzimet publike financohen nga mjetet e grumbulluara nga tatimet, kontributet, taksat, të ardhurat jotatimore dhe nga ndonjë instrument tjetër i grumbullimit të të ardhurave.


Barazia e shpenzimeve publike më së shpeshti në një ekonomi të paster “laissez-faire” mund të krijojë pabarazi të lartë të papranueshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve. Rishpërndarja e të ardhurave nëpërmjet transferave dhe programeve sociale paraqet aktivitetin e shtetit për rregullimin e funksionit- barazi. Në ekonomite në tranzicion ndonëse me të ardhurat “per capita” ngelin shumë pas vendeve të zhvilluara dhe kjo dukuri mbështetet në rënien drastike të prodhimtarisë së këtyre vendeve dhe në shpenzimet e medha për mbrojtjen sociale të të papunësuarve dhe numrin gjithnjë e më të madh të personave të varfër.

Shpenzimet publike nga dita në ditë gjithnjë e më shumë ndikojnë në menyrë koniukturale, zhvillimore dhe stabilizuese në ekonomi. Në këtë aspekt, ndikimi i shtetit me instrumentin e tij- shpenzimet publike në ekonomi janë të mëdha dhe të llojllojshme dhe thuajse sikur nuk ekziston asnjë agregat ekonomik ndaj të cilit nuk ndikojnë shpenzimet publike. Në rritjen e

shpenzimeve publike më parë ndikim kanë rastet politike (luftat potenciale), rastet sociale në shtet (numri, lloji dhe sasia e transferave sociale), si dhe gjendja në ekonomi (inflacioni, papunësia, dezinvestimi, recesioni, çregullimi i rrjedhave ekonomike dhe të ngjajshme).

Në tabelën vijuese është paraqitur sasia e pjesëmarrjes së shpenzimeve publike të shprehura me përqindje të PBB-së së vendeve në tranzicion.

**Grafikoni 2.5 Shpenzimet qeveritare**



imi: Kalkulim nga autori

Megjithatë, me paraqitjen e krizes së madhe financiare globale. Nga viti 2007 deri kah viti 2010, për nevoja të stabilizimit të cikleve ekonomike, sërish fillonë rritja e shpenzimeve publike, që për pasojë shkakton rritje të larta të defiçiteve buxhetore dhe me këtë edhe të borxhit publik.

Kriza globale financiare, edhe pse në periferi godet me vonë, nuk i „kurseu,, edhe shtetet e tranzicionit për të rikthye nivelin e shpenzimeve publike (si % e PBB-së). Rritja e shpenzimeve vërehet në të gjitha vendet e prezantuara, përveç Shqiperisë e cila arrinë norma më të ulta në krahasim me vendet tjera te tranzicionit, ndërsa Kosova, Sërbia, Hungaria kanë arritur ti stabilizojnë shpenzimet publike dhe ti ulin në nivel të përbalueshëm në vitet e fundit - në rreth 16% te PBB-së.

Në këto vende vërehet dallim i dukshëm, për sa i përket shumës së shpenzimeve për funksione të caktuara si për shembull: shpenzime për shërbime të përgjithshme publike lëvizin prej 15.76% (në Estoni ) deri më 20.27% dhe prej 17.38 (në Rusi) deri më 19.06%. Shkaqet e nivelit të lartë të shpenzimeve publike më së shpeshti janë: niveli relativisht i ulët i prodhimit bruto shoqëror, rritja rapide e të ashtuquajturave shpenzime të tranzicionit, të cilat janë rezultat i ristruktuimit teknik, organizativ, financiar dhe pronësor të ekonomisë, rritja e


shpezimeve të transfere për pagimin e kompensimeve të punëtorëve të dalë nga puna, sigurim social dhe të ngjashëm dhe rritja e tarifave të mbrojtjes (shtete e posakrijuara dhe rrethanat konfliktuale midis tyre) si dhe për vendosjen e rrjetit diplomatik-konsular pas pavarimit të tyre,..etj. por transferat për sigurim social janë shkalla më e lartë e shpenzimeve qeveritare në shumë vende në tranzicion por ka hapsirë për racionalizim, posaçërisht në pjesën e rrogave, transferat e sigurimit social dhe ndihmën sociale si dhe në sektorin shëndetsor.

### 2.2.5 Te ardhurat publike

Nga këndvështrimi historik, zhvillimi i të ardhurave publike tregon se, sipas vendit, rolit, efekteve, objektivave dhe sipas menyrës së mbledhjes (kolektimit) të tyre, të ardhurat shtetërore kanë ndryshuar sipas rrjedhës së kohës.

Si burim kryesor i të ardhurave publike i kemi tatimet, taksat ku kryesisht nga pikëpamja financiare taksat janë një burim të hyrash me rëndësi, sidomos për entet lokale dhe komunat, respektivisht për pushtetin vendor. Gjithashtu i kemi edhe kontributet sociale, të ardhurat tjera (të ardhurat nga emetimi i parave, të ardhurat nga donacionet, të ardhurat nga koncesionet).

**Grafikoni 2.6 Te ardhurat publike**



imi: Kalkulim nga autori


Siç e shohim nga grafiku, Republika Çeke dhe Rusia përfaqesojnë të ardhura publike ndaj PBB-së më të ulta në të gjithë vendet e tranzicionit. Ndërkohë në vend të parë mbas Estonisë rradhitet Kosova (28.16%) e ndjekur nga Shqipëria (26.04%), Hungaria (23.44%), Sërbia (21.20%), Maqedonia e veriut (17.13%) dhe Polonia (16%) e marur në vitin 2012. Shohim që vendi me rritje më të madhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është Estonia, ndërsa vendi me ulje më të madhe të të ardhurave publike e kemi Republikën Çeke. Këto të ardhura kryesisht

bazohen në taksat, tatimet e mbledhura nga një shtet gjatë një periudhë të caktuar kohore. Ndikohen nga niveli i tatimeve, dhe nga aftësia e shtetit për ti grumbulluar këto tatime dhe për të zvogluar evazionin fiskal.

### 2.2.6 Indeksi i çmimeve të konsumit

Indeksi i çmimeve të konsumit është një tregues matës për nivelin e çmimeve të konsumatorëve, ky indeks me një fjalë përdoret si mates i inflacionit, llogaritet duke përdor strukturën e konsumit përfundimtar gjithashtu është shumë i rëndësishëm sepse mat ndryshimin e nivelit të çmimeve të shërbimeve dhe mallrave të cilat kryesisht përdoren nga njësitë ekonomike familjare për konsum vetjak.

**Grafikoni 2.7 Indeksi i çmimeve të konsumit**



urimi: Kalkulim nga autori

Indeksi i çmimeve të konsumit, duke filluar nga viti 2009 llogaritet me shportën e artikujve, pesha e të cilave janë llogaritur duke u bazuar në rezultatet e anketës së buxhetit të familjeve. Indeksi i parë që shënon rritje permanente krahasuar me vendet tjera të tranzicionit është Kosova që arrinë normën më të lartë në vitin 2011 me 90.46%, ndërsa pas saj rradhitet Shqipëria ka pasur një rritje të qëndrueshme brenda këtyre viteve, në vitin 2017 rritja vjetore e çmimeve është ndikuar më shumë nga grupi i pijeve joalkoolike dhe ushqime krahasuar në vitin e mëparshëm.

Në vend të parë pas Kosovës dhe Shqipërisë, rradhitet Sërbia (74.68%), Maqedonia e Veriut (67.71%), Polonia (58.47%), Rusia (51.87%) dhe me pas Estonia, Hungaria dhe Republika Çeke e marur në vitin e fundi.



### **3. SHQYRTIMI I LITERATURËS**

#### **3.1 ASPEKTI TEORIK**

Shpërndarja e pasurive është një nga çështjet më të debatuar në ditët tona. Trendi në vitet e fundit tregon, se edhe mëtutje vazhdon rritja e tendencës së pabarazisë në shpërndarje. Ky fenomen, i cili haste edhe në shtetet më të zhvilluara, paraqet sfidë për shpërndarjen e drejte dhe të ndershme. Pesëdhjetë vitet e fundit, ekonomistët gjithnjë e më tepër konsiderojnë se teoria e shpërndarjes së drejtë dhe të ndershme nuk bie në pjesën e ekonomisë, por ajo duhet lënë në kompetencë të filozofëve dhe politikanëve. Interesi përfundimtar i shpërndarjes së drejtë, u përket shpërndarjeve midis individëve dhe familjeve dhe jo midis grupeve të faktorëve. Pjesëmarrja e faktorëve është lirshëm e lidhur me shpërndarjen e të ardhurave midis familjeve. Ndonëse është e saktë, se të ardhurat kapitale u përkasin familjeve me të ardhura më të larta, kurse të ardhurat me pagat u përkasin familjeve me të ardhura më të ulta, ekzistojnë përjashtime të rëndësishme nga kjo rregull, prandaj problem i shpërndarjes midis individëve dhe familjeve duhet të vihet në rrafshin horizontal.

Studimet që janë bërë dhe lind pyetja se përse ekziston një pabarazi kaq e madhe në të ardhurat, ka zënë për shumë kohë vendin kryesor në ekonomiks dhe akoma nuk i është dhënë një përgjigje e sakt (Atkinson, 1983). Në disa vende arsyeja kryesore për ekzistencën e pabarazisë në të ardhurat e familjeve është ndryshimi në pagat. Shumë ekonomistë besojnë se faktori kyç që ka nxitur rritjen e pabarazisë këto vitet e fundit janë të ardhurat financiare gjithnjë më të larta të siguruara nga arsimiti- për shkak të ndryshimeve të teknologjisë të tilla si: përhapja e gjërë e kompjuterëve në vendet e punës, punonjësit me arsim të lartë tani fitojnë më shumë relativisht ndaj atyre me arsim të ulët. Siç do të shohim ky fakt ka vështirësuar përpjekjet për të formuar politika të drejta për shpërndarjen e të ardhurave (Rosen, 2003).

Të ardhurat shpërndahen pa dyshim në menyrë jo të barabartë, individët nuk janë dakord me faktin nëse qeveria duhet të ndermarrë politika rishpërndarëse (Rosen, 2003). Shpërndarja e të ardhurave mund të shihet si një e mirë publike, sepse dobia e secilit ndikohet nga shkalla e pabarazisë, asnjë individ duke vepruar i vetëm nuk do ishte i gatshëm të transferonte paratë në dobi të të varfërit. Nëse qeveria përdor fuqinë e saj detyruese për të detyruar çdokënd, i cili është i pasur të rishpërndaje të ardhurat në dobi të të varfërve, efënca ekonomike rritet. Duke

shpenzuar para për shtresat më të pambrojtura të popullatës (të papunësuarit, pleqtë dhe të varfërit), shteti bën korigjimin e shpërndarjes së të ardhurave, që është rezultat i ndikimit të forcave të tregut. Ky korigjim, përkatësisht rishpërndarje e të ardhurave sqarohet me nevojën, që asnjë qytetarë të mos bjerë nën nivelin e përcaktuar minimal të standardit të jetesës. Nëse qytetari vetë nuk është në gjendje të sigurojë këtë nivel minimal të standardit të jetesës, atëherë atë duhet t'ia sigurojë shoqëria-shteti.

Ekonomisti Paul Krugman, argumenton se rritja e ulët ekonomike shkakton rritjen e borxhit publik dhe jo e kundërta edhe periudha e viteve 2008-2010 rezultoi me përkeqësim fiskal (rritje defičiti dhe borxhi), kjo si rezultat i shpenzimeve publike rritëse dhe joproductive. Përmes shpenzimeve publike, përkatësisht transfeve buxhetore shteti duhet të sigurojë barazi në shtresat më të rrezikuara të popullatës, duke ju siguruar kushte më minimale për jetesë. Sa u përket shpenzimeve sociale shpesh quhen si subvencione sociale, që paraqesin forma të ndryshme të ndihmave sociale, mbrojtje sociale të fëmijëve dhe pleqve, invaliditeti, shëndetsi falas, bursa të ndryshme etj., të cilat individëve të caktuar u mundësojnë të vijnë të ardhurat, që nuk i disponojnë fare. Në rastin e Maqedonise së Veriut, programet sociale janë të fragmentuara dhe jo të sistemuara si duhet statistikisht sepse nuk egziston një model i statistikave sociale ku do të publikohen indikatorët bazik social. Studimet dhe analizat e fundit na dëshmojnë se megjithë shumat e mëdha të mjeteve publike të shpenzuara për programe sociale, vazhdon „ shkrirja,, e shtresës së mesme sociale, në kryesisht shtresës së varfër dhe pjesërisht në të pasur.

### **3.1.1 Teoria neoklasike**

Ekonomia neoklasike është një qasje ku ekonomitë përqendrohen në përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve dhe shpërndarjen e të ardhurave përmes kërkesës dhe ofertës. Edhe pse ekonominë neoklasike e kanë pranuar shume ekonomistë bashkohorë por ajo ka pasur shumë kritika të ekonomisë neoklasike.

Teoria e rritjes sipas modelit neoklasik është të sqarojë përcaktuesit e normave të rritjes në një vend, kanë qenë dy periudha në teorinë e rritjes; e para në fund të viteve 1950 dhe 1960 dhe e dyta 30 vjet më vonë në fund të viteve '80 dhe 1990. Kërkimi në periudhën e parë krijoi teorinë neoklasike të rritjes. Ndihmesa më e mirënjohur e asaj periudhe u bë nga Robert Soloë. Kërkimi më i vonshëm është njohur si teoria e rritjes endogjene

Teoria neoklasike e rritjes përdor këto dy ekuacione si në vijim:

$$Y=AF(K,N)$$

ku:

Y= produkti agregat

K= stoku i kapitalit

N= forca e punës

Rezultati i fundit i teorisë neoklasike ka të bëj me konvergjencën, në qoftë se dy vende kanë të njëjtën normë të rritjes së popullsisë, të njëjtën normë kursimi dhe kanë kontakt me të njëjtin funksion prodhimi, ato përfundimisht do të arrijnë të njëjtin nivel të ardhurash. Në të kundërt vendet e varfëra janë të tilla sepse ato kanë më pak kapital, por në qoftë se ato kursejnë me të njëjtën normë sikurse edhe vendet e pasura dhe janë në kontakt me të njëjtën teknologji, ato përfundimisht do të arrijnë këto vende. Por në qoftë se vendet do të kenë norma të ndryshme kursimi atëherë sipas teorisë së thjeshtë neoklasike ato do të arrijnë nivele të ndryshme në të ardhurat e gjendjes së pandryshuar, por në qoftë se norma e tyre të pogramit teknik janë të njëjta, norma e tyre e rritjes së gjendjes së pandryshuar do të jetë e njëjtë.

Robert Barro arrinë të konkludojë se vendet që investojnë më shumë tentojnë të rriten më shpejtë, veprimi i investimeve të larta në rritje duket të jetë kalimtare sa më shumë investitorët do të përfundojnë në një gjendje të pandryshuar me të ardhurat për fryme më të larta, por jo me një normë më të lartë rritjeje. Kjo është çka predikohet nga teoria neoklasike. Barro i referohet këtij rezultati si konvergjencë e kushtëzuar, që do të thotë se vendet po konvergjojnë në gjendjet e pandryshuara nga pjesa e investimeve në GDP. Nivelet gjithashtu janë të kushtëzuara nga variabla të tjerë, si pjesa e shpenzimeve qeveritare në GNP dhe norma e investimeve në kapitalin human. Gregory Mankië, David Romer, David Ëeil (1992), përfshirja shprehimisht në modelin neoklasik të kapitalit human mund të meret parasysh për një pjesë të fenomenit, si për ndryshimet që mbeten për një kohë të gjatë në normat e rritjes, që u mendua se kërkojnë modele të rritjes endogjene

### **3.1.2 Teoria Neokejnziane**

Pjesa më e madhe e teorisë ekonomike neo-kejnziane u zhvillua nga John Hicks dhe Maurice Allais dhe u popullarizua nga ekonomisti matematikor Paul Samuelson. Procesi filloi menjëherë pas publikimit të teorisë së përgjithshme të Kejnzit me modelin IS/LM (investment saving) kursimi i investimeve dhe (liquidity preference money supply)

preferenca e likuditetit e ofertës së parasë, i prezantuar për herë të parë nga John Hicks në vitin 1937. Ajo vazhdoi me adaptimet e modelit të ofertës dhe kërkesës së tregjeve me teorinë Kejnziane.

Teoria neo-kejnziane përqendrohet në rritjen ekonomike dhe stabilitetin e punëzënies së plotë, gjithashtu teoria neo kejnziane e identifikon tregun si jo vetë-rregullues. Arsyet që neokejnzianët identifikuan se tregu nuk ishte vetë-rregullues ishin të shumëllojshme. Së pari, mund të ekzistojnë monopole, që do të thotë se tregu nuk është konkurrues, gjithashtu kjo nënkupton se ndërmarrjet kanë fuqi diskrecionale për të vendosur çmimet dhe mund të mos dëshirojnë të ulin ose rrisin çmimet.

Soloë (1956), ka treguar ku të gjithë variablat – prodhimi, të ardhurat, fitimet, pagat, kapitali, çmimet e aktiveve dhe pasurive të patundshme, etj – përparojnë me të njëjtin rritim, aq sa çdo grup shoqëror përfiton nga rritja në të njëjtat përpjestime, pa dallime të mëdha. Kjo është e kundërta absolute e spirales së pabarabartë të Rikardos ose asaj marksiste dhe analizave apokaliptike të shekullit XIX. Stiglitz (2012), kritikon pabarazinë e rritjes së pasurisë dhe efektet e dëmshme që krijohen në ekonomi. Stiglitz thekson se pabarazia është e pavarur, bazuar në akumulimin e fuqisë politike ku përqendrohen në resurset ekonomike dhe kjo u lejon atyre që të përfundojnë kontrollin ligjvënës dhe rregullator në favor të interesave të tyre.

### **3.2 Evidenca empirike**

Në bazë hulumtimeve dhe studimeve që janë bërë nga shumë autorë të ndryshëm, do të shohim edhe aspektin empirik në mes pabarazisë dhe rritjes ekonomike. Pabarazia është një nga çështjet më të debatuar në ditët tona, Paul Krugman, Joseph Stiglitz dhe Thomas Piketty sqarojnë nevojën për reduktimin e pabarazisë, taksën progresive e vendosin mbi pasurinë dhe të ardhurat personale.

Piketty (2013), studjoi korrelacionin midis pabarazisë në lidhje me punën dhe pabarazitë në lidhje me kapitalin, në praktikë, korrelacioni ndërmjet të dyjave përmasave shpesh është i dobët ose negative në shoqëritë kur pabarazia ndaj kapitalit është kaq e forte sa u lejon pronarëve të mos punojnë. Kur përpiqet të matë pabarazinë e të ardhurave, pabarazia e kapitalit është gjithmonë shumë më e fortë se sa pabarazia në lidhje me punën. Në bazë analizës empirike në shoqëritë ku pabarazia e të ardhurave nga puna është relativisht e ulët, ku 10% e të paguarit mirë marrin rreth 25% të të ardhurave nga puna, 50% të paguarit më pak apo klasat popullore marrin rreth 30% dhe 40% të mesit rreth 45%. Koeficienti

përgjegjës i Gini-t (tregues sintetik i pabarazisë që shkon nga 0-1) është 0.26. Në shoqëritë që karakterizohen nga një pabarazi e pronësisë së kapitalit, 10% e të pasurit në pasuri zotërojnë rreth 60% të pasurive, 50% klasat popullore zotërojnë rreth 5%, dhe 40% të mesit rreth 35%. Koeficienti përgjegjës i Gini-t është 0.67%. Vëmë re se pabarazia mbetet e forte në shoqëritë ideale. Edhe E.Öolff dhe A.Zacharias (2009), kontributin e japin tek korrelacioni në mes pabarazisë në lidhje me punën dhe kapitalin, ata konkludojnë se të ardhurat nga kapitali priten gjithmonë të jenë më të larta se të ardhurat nga puna kur ngjysim shkallet e hierarkisë së pagave. Dallimet në kohë dhe hapësirë janë dallime të shkallës: ato janë të rëndësishme, por nuk ndryshojnë parimin e përgjithshëm. Joseph E. Stiglitz (2012), në studimin e tij që e ka bërë, në përfundim arrinë të analizojë marrëdhënien komplekse e pabarazisë, ai veçon Francën dhe Norvegjinë ku janë shembuj për tu ndjekur nga ana e menaxhimit të pabarazisë, në masë të madhe rezistojnë trendin e rritjes së pabarazisë në vend, gjithashtu Brazili dhe Amerika latine kanë arritur që të reduktojnë pabarazinë nga një nivel tejet i madh në nivele më të ulta. Vendet skandinave kanë nivel shumë të lartë të barazisë ku veçohet nga të tjerët. Ai gjithashtu arsyeton se pabarazia në rishpërndarjen e të ardhurave paraqet një shpenzim i cili nuk është i dobishëm, dhe një kosto shtesë paraqet një shpenzim shtesë. Ai analizon edhe tregun imobiliar ku me anë të krizës e vitit 2008, miliona njerëz kanë nevojë vetëm për një çati, ndërsa nga ana tjetër nuk ka blerës për shtëpitë të cilët janë lënë nga individët që nuk kanë arritur që të paguajnë kredinë.

Sipas Kuznets (1955), pabarazia e të ardhurave do të zvoglohet automatikisht në fazat e përparuara të zhvillimit kapitalist, pavarësisht nga politikat e ndjekura apo karakteristikat e vendit dhe pastaj stabilizohet në një nivel të pranueshëm. Analiza e Robert Soloë me 1956 mbi kushtet e një “shtegu të rritjes së ekuilibruar”, domethënë një trajektore të rritjes ku të gjitha variablat-prodhimi, të ardhurat, fitimet, pagat, kapitali, çmimet e aktiveve dhe pasuria e patundshme, etj-përparojnë në të njëjtin rritëm, aq sa çdo grup shoqëror përfiton nga rritja në të njëjtat përpjestime, pa dallime të mëdha. Kjo është e kundërta absolute e spirales së pabarabartë të Rikardos ose asaj marksiste dhe e analizave apokaliptike të shekullit XIX. Për të kuptuar mirë ndikimin e konsiderueshëm të teorisë së Kuznes-it, të paktën deri në vitet 1980-1990 dhe në një farë mase deri në ditët tona, duhet këmbngulur në faktin se ajo është teori e parë në këtë fushë që mbështetet në një punë statistikore. Kuznets (1955) trajton vetëm një vend (SHBA) në një periudhë prej tridhjetë e pesë vitesh, gjithashtu mobilizon dy burime të dhënash: nga njëra anë, deklaratat e të ardhurave të nxjerra nga tatimi federal mbi të ardhurat e krijuar në vitin 1913, nga ana tjetër, vlerësimet e të ardhurave kombëtare, disa vite

më parë. E rëndësishme të kuptohet se pa këto dy burime është e pamundur të maten pabarazitë e shpërndarjes së të ardhurave. Ai konstaton se midis viteve 1913 dhe 1948 ndodh një zvoglim i fortë i pabarazisë në të ardhura.

Për dhjetëvjeçarë të tërë Maltusi, Rikardoja, Marksi dhe shumë të tjerë flisnin për pabarazinë, por pa sjelle as më të voglin burim, as më të voglën metodë që do të lejonte të krahasoheshin me saktësi epokat e ndryshme dhe të zgjidhej ndërmjet hipotezave të ndryshme. Në librin e tij “ Rritja ekonomike dhe pabarazite e të ardhurave” Kuznet do të sjellë edhe teorinë e “kurbës së Kuznets-it” Sipas kësaj teorie gjatë procesit të industrializimit dhe të zhvillimit ekonomik, pabarazia pritet të ndejkë kudo një “kurbë në formë kambane”, domethënë në fillim rritëse pastaj zbritëse. M. Kuhof, R. Ranciere (2010), sipas tij, rritja e pabarazise ka kontribuar në paqëndrueshmërinë e sistemit financiar, ku rritja e pabarazive ka pasur për rrjedhojë një gati-stanjacion të fuqisë blerëse të klasave popullore dhe të mesme, ku ka rritur tendencën në rritje për të hyrë me borxhe, ku në të njëjtën kohë bankat dhe ndërmjetësit financiar të paskrupuj dhe të etur për të gjetur rendimente të mira për kursimet financiare gjigante të injektuara në sistem nga kategoritë e pasura, ku u propozonin kredi gjithnjë më të lehta dhe pa rregulla.

Ne tezën e rëndësishme të A. Atkinson, T. Piketty, E. Saez ata analizuan që gjatë tridhjetë viteve që i paraprinë krizës, domethënë nga 1977 me 2007, konstatojnë se 10% e të pasurve kanë përvetsuar tre të katërtat e rritjes; vetëm 1% me të pasurit kanë thithur gati 60% të rritjes totale të të ardhurave kombëtare amerikane në këtë periudhë, për 90% të tjerët, norma e rritjes së të ardhurave mesatare është zvogluar në më pak se 0.5% në vit. Milton Friedman (1957), të ardhurat permanente të konumit argumenton se konsumi nuk është i lidhur me të ardhurat korrente, por me një vlërsim më afatgjatë të të ardhurave, ku e paraqiti teorinë, të ardhurat permanente. Një shqyrtim i hollësishëm i prirjeve për konsum i realizuar nga Shaldon Dauzigar, Jacques VanDer Gaag, Eugene Smolensky dhe Michael Taussig, përmban konkluzionin e rëndësishëm se të moshuarit kursejne një përpjesim më të lartë të të ardhurave të tyre se sa të rinjtë, rezultatet janë gjetur se të moshuarit zakonisht jetojnë në një shtëpi dhe e grumbullojnë pasurinë me femijët e tyre. Ata ndoshta harxhojnë pasuri gjat periudhës së pensionit, por pasuria e tyre nuk dallohet nga ajo e femijëve, të cilët janë gjithashtu duke kursyer. Sjellja e të moshuarve duhet të shpjegohet duke mbajtur parasysh frikën në rritje të të qenit vetëm, pa ndihmë financiare nga familja dhe, teksa plaken, me shpenzime të mundshme mjeksore më të mëdha. Nevoja për pasuri mund të rritet me moshë në qoftë se nuk sigurohet një sigurim i plotë për shpenzime mjeksore-ku nuk është i tillë. Nëse njerëzit kursejnë për periudhën e jetës së tyre ose gjithashtu kursejnë për t’ua lënë pasurine femijëve

– duke përfshirë transferimet që ndodhin gjat jetës së prindërve, si pagesa për edukimin universitar – kjo nuk ndikon faktin se pasuria i takon funksionit të konsumit. Hebert Stein (1969), analizon progresin drejt masës kryesore politike në fillim e viteve 1960, shkurtimit të taksave në vitin 1964, ai tregon se si administratë e Kennedyit dhe Kongresi duhej të mësoheshin me idenë se një shkurtim taksash që rrit deficitin buxhetor gjat një rënie ekonomike, nuk përfaqëson me doemos një hap drejt një politike fiskale të papërgjyeshme. Stigler (1970), rishpërndarja e të ardhurave favorizon kryesisht individet me të ardhura mesatare: “Shpenzimet publike kryhen për të siguruar, së pari, përfitimet për klasat e mesme, ato financohen nga tatimet që përballohen në menyrë të konsiderueshme nga të pasurit dhe të varfërit.” Por, ekzistojnë, gjithashtu, programe qeveritare transfertash me përfitues të pasurit. Disa programe transfertash, në përfitim të klasave të ndryshme të të ardhurave, mund të ekzistojnë në të njëjtën kohë, kështu pikëpamjet e ndryshme mbi rishpërndarjen nuk përjashtojnë domosdoshmërisht njëra-tjetrën.

Robert Eisner (1989), vlerëson një seri të përshtatur të GNP në të cilën niveli i GDP reale është rreth 50% më i lartë se vlerësimet zyrtare, ritmi i vlerësuar i rritjes së GDP reale gjat periudhës 1946-1981 është pothuajse i njëjti në vlerësimin zyrtar. Rritja e GDP në periudhën 1977-1990 sipas series së vjetër (mbështetur në çmimet e vitit 1982) 2.7% në vit. Por me rishikimet e të dhënave dhe me zhvendosjen e vitit bazë në vitin 1987, realizuar në vitin 1991, ritmi i rritjes për periudhën 1977-1990 vlerësohet të ketë qenë vetëm 2.5% në vit.

Mancur Olsen (1982), shoqëritë që kanë kaluar nëpër lëkundje të mëdha, kanë mundësinë që për pak vjet të rindërtojnë ekonominë në linja më racionale. Sigurisht duhet më shumë se një revolucion për të rivendosur rritjen. Qeveria e re duhet gjithashtu të vendosë një kuadër ekonomik mjaft të qëndrueshëm për të ndjekur politika pro rritjes dhe të lejojë iniciativën private që të zhvillohet lirisht. Punimi i Olsenit ngre çështjen e rëndësishme nëse vendet mund të reformohen efektivisht, pa një lëkundje apo tronditje të madhe, të tillë si depresioni i madh.

## 4. METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

Përmes modeleve dhe metodave ekonometrike ne do ti testojmë se si ndikojnë faktorët makroekonomik në Gin indeksin në disa vende të tranzicionit, ku si fillim ne do arrijmë që të realizojmë trajtimin dhe specifikimin e modeleve ekonometrike, ku më pas do të bëjmë përlllogaritjen e modeleve si dhe interpretimin e tyre.

### 4.1 METODOLOGJIA

Në këtë punim do të përdorim metoda të ndryshme si Panel Data, e cila është një metodë statistikore e përdorur më së tepërmi në shkencat shoqërore, ekonometri dhe epidemiologji, për të analizuar të dhënat dydimensionale zakonisht ( Cross sectional dhe Longitudinal), të dhënat zakonisht mblidhen me kalimin e kohës dhe mbi të njëjtët individë ku më pas zhvillohet një regresion mbi këto dy dimensione. Analiza shumëdimensionale paraqet metodën ekonometrike, ku në bazë kësaj analize të dhënat mblidhen në shumë dimensione, si: kohore, tipike, individuale dhe në disa raste të dimensioneve të treta). Gjithashtu metoda Panel, është një teknikë statistikore që përdor tre qasje: qasja fikse, qasja e rastësishme dhe qasja Husmman–Taylor.

Një model i zakonshëm i regresionit të panel data duket si  $Y_{it}=a+bx_{it}+\epsilon_{it}$ ,  $y$  është variabla e varur,  $x$  variabla e pavarur,  $a$  dhe  $b$  janë koeficientët,  $i$  dhe  $t$  janë individët dhe koha, error term ( $\epsilon_{it}$ ) është shumë e rëndësishme në këtë analizë. Supozimet rreth error term përcaktojnë nëse flasim për efektet fikse ose të rastit. Në një model me efekte fikse  $\epsilon_{it}$  supozohet të ndryshon në mënyrë jo stokastike mbi  $i$  ose  $t$  duke krijuar model të efekteve fikse që janë të ngjajshme me modelin dummy variabla në një dimension. Në modelin e efekteve të rastësishme,  $\epsilon_{it}$  supozohet të ndryshojnë në mënyrë stokastike mbi  $i$  ose  $t$ , që kërkojnë trajtim të veçantë në matricë në variancës error.

Analiza e Panel Data ka tre më shumë ose më pak qasje të pavarura:

- Independently Pooled Panel
- Random Effects
- Fixed Effects



Zgjedhja midis këtyre metodave nvalet nga objektivi i analizës dhe problemeve në lidhje me ekzogjenitetin e variablave shpjeguese. Panel Data mund që të kontrolloje disa variabla të cilat nuk janë të observuar në model, ku kryesisht duke i observuar ndryshimet që ndodhin në variablën e varur në periudha të ndryshme kohore. Tek ky hulumtim shkencor do të paraqes analizën empirike për të testuar variablat kryesore dhe do të shohim a do të ndikojnë pozitivisht apo negativisht në Gin index, në vendet e tranzicionit.

## **4.2 SPECIFIKIMI I MODELIT TË REGRESIONIT TE THJESHTE LINEAR**

Përmes metodës së regresionit të thjeshtë linear dhe përmes aplikimit të metodës së katrorëve të vegjël (OLS), në këtë hulumtim ne do të testojmë efektet e Gin index dhe GDP-së (indeksin e korrupsionit, indeksin e çmimeve të konsumit, shpenzimet qeveritare, të ardhurat publike, subvencionet dhe transferat) në vendet e tranzicionit.

Përlllogaritjet do të realizojmë përmes modelit të regresionit linear tredimensional ashtu si e kemi në vijim:

$$Y = A_1 + A_2X_1 + A_3X_2 + A_4X_3 + A_5X_4 + A_6X_5 + A_7X_6 + u_i$$

Y= paraqet variablën e n'varur në rastin tonë e kemi Gdp per capita dhe Gin indexin

X= variabël e pavarur në rastin tonë i kemi: A1, A2, A3, A4, A5, A6 dhe A7 gjithashtu këto thiren si koeficientët e vlersimit; A1, paraqet parametrin e konstantës, A2, A3, A4, A5, A6, A7 janë koeficientët e vlersimit të variables së pavarur

$u_i$ = paraqet variablën stokastike ose ndryshe error term, përmban të gjitha variablat të cilët nuk janë të përfshirë në model dhe është variabël random e pa observuar ku mer vlera negative ose pozitive

## **4.3 METODA E VLERSIMIT TË KATRORËVE TË VEGJËL (OLS)**

Kjo është një metodë statistikore që vlerëson lidhjen midis një ose më shumë variablave të pavarur dhe një ndryshore të varur; metoda vlerëson marrëdhënien duke minimizuar shumën e katrorëve, tek ky model ekziston vetëm një ndryshore e pavarur (X) që parashikon një variabël të varur (Y), variabla e varur (Y) është variabël e vlersuar ku kryesisht kërkohet të parashikohet me anën e një tjetër variabël. Variabla e pavarur siguron bazën për vlersim, ku me anë të kësaj bëhet parashikimi i variablës të varur.



Error term në këtë model është një variabël e mbetur e krijuar nga një model statistikor ose matematikor, i cili krijohet atëherë kur modeli nuk e përfaqëson ose paraqet marëdhënien midis ndryshoreve të pavarur dhe ndryshoreve të varur. Si rezultat i kësaj marëdhënie jo të plote termi error është shuma në të cilën ekuacioni mund të ndryshojë përgjat analizës empirike. Error term njihet si mbetje ose tepricë ku gjithashtu përfaqësohet në mënyra të ndryshme në shkornjat  $e$ ,  $\varepsilon$ , ose  $u$ .

Kur variabla  $Y$  aktuale ndryshon nga  $Y$  e parashikuar në model gjat një testimi empirik, atëherë error term nuk është i barabartë me 0, që do të thotë se ka faktorë tjerë që ndikojnë në  $Y$ . Si përfundim error term, shfaqet në një model statistikor, si një model regresioni për të treguar pasigurinë në model.

#### 4.4 MODELI FIXED EFFECTS DHE RANDOM EFFECTS

Në ekonometri dhe statistikë, modeli “Fixed Effects” kryesisht është një model statistikor ku parametrat ose variablat e modelit janë sasi fikse dhe jo të rastit. Kjo është me kundërshtim me modelet e “Random Effects” dhe “Mixed Effects” ku disa nga variablat e modelit konsiderohen si ndryshore të rastit. Në shumë zbatime duke përfshirë ekonometrinë dhe biostatistikën një model me “Fixed Effects” mund të themi që i referohet një model regresioni në të cilën mjetet janë fikse (jo të rastit) në krahasim me modelin “Random Effects” në të cilën këtu mjetet janë të rastit. Sa i përket metodës së efekteve të rastësishme është model statistikor ku parametrat e modelit janë ndryshore apo variabla të rastit. Është model linear hierarkik, i cili supozon që të dhënat që analizohen nxirren nga një hierarki e ndryshme e popullatës, ndryshimet e të cilave lidhen me atë hierarki. Në ekonometri, modelet e efekteve të rastësishme janë përdorur në analizën e paneleve të hierarkise, ky model është rast i veçantë i modelit të efekteve fikse.

Egzistojnë dy supozime të zakonshme të ndërtuara në lidhje me efektin specifik individual:

-  Supozimi i efekteve të rastit “Random Effects”
-  Supozimi i efekteve fikse “Fixed Effects”

Supozimi i “Random Effects” ka të bëjë me atë se efektet specifike individuale nuk janë të lidhura me ndryshoret apo variablat e pavarura. Ndërsa supozimi i “Fixed Effects” këtu efektet specifike individuale lidhen me ndryshoret e pavarura. Mund të cekim që Testi Durbin-Ëu-Hausman shpesh përdoret për të bërë dallimin midis modeleve të efekteve fikse dhe atyre të rastit.

Dukemare ne konsiderate modelin në vijim:

$$X_U = Y_U + E_U$$

Si dhe 'Error Term' ka këtë strukturë:

$$E_U = \alpha_i + n_{it}$$

Termi i parë konsiderohet si efekt specifik-individual, ndërsa pjesa e dytë korrespondon termin si "Common Stochastic Error Term", në pjesën e parë e cila ndyshon në bazë individëve apo njësive, ku në rastin tonë i kemi shtetet, e rëndësishme të ceket që kjo pjesë mund të jetë në lidhje me variablat sqaruese, ndërsa sa i përket pjesës së dytë kjo varion në mënyrë arbitrare në bazë kohës dhe vendeve.

#### 4.5 MODELI FIXED EFFECTS

Në bazë të kësaj metode në bëjmë analizën e parametrave të cilët ndryshojnë gjatë kalimit të kohës, që do të thotë se duhet të shfrytëzohen efektet fikse nëse dëshirojmë të analizojmë ndikimin e parametrave të cilat ndryshojnë në kohë. Metoda e efekteve fikse bën shqyrtimin e parametrave të parashikuara si dhe rezultatet e variablave brenda një njësie ekonomike (shteti, personi, vendi, kompani etj.). Secili entitet ka karakteristikat e veta kryesore që mund ose nuk mund të influencojë tek variablat e parashikuara.

Mund të cekim që avantazhi i këtij modeli është eliminimi i heterogjenit specifik individual, që paraqitet nga qasja "Deviations From Means", duke e paraqitur ekuacionin si në vijim:

$$\bar{x} = \bar{Y}_i + A + \alpha_i + n_i$$

$$x_{it} - \bar{x}_i = (Y_{it} - \bar{Y}_i) \mathbf{b} + (n_{it} - n_i)$$

Derisa përdorim efektet fikse, supozojmë se brenda një individi mund të paraqiten paragjykime në rezultatin e variablës ku kemi nevojë për ti kontrolluar, për arsye se pas supozimit midis parametrave tek njësia ekonomike gabimisht mund të parashikohet.

Ekuacioni për modelin e efekteve fikse bëhet si vijon:

$$X_{it} = \beta_1 Y_{it} + \alpha_i + u_{it} \quad \text{per } t=1 \text{ dhe } i=1, \dots, N$$

$X_{it}$ - është variabël e varur

i-entitet

t-koha

$\beta_1$ -është parametri ose koeficienti për variablen e pavarur

$\alpha_i$ -është i panjohur në secilin entitet

uit- paraqet gabimin standard apo (error term)

Y1- variabël e pavarur (iv)

Mënyra tjetër që veçohet për të parë modelin “Fixed Effects” është përdorimi i ndryshoreve binare, ekuacioni në këtë rast paraqitet si në vijim:

$$X_{it} = \beta_0 + \beta_1 Y_{1,it} + \dots + \beta_k Y_{k,it} + \gamma_2 E_2 + \dots + \gamma_n E_n + u_{it}$$

**Ku kemi:**

**X<sub>it</sub>**- paraqet variablën e varur, ku **t**=koha dhe **i**=entitet,

**Y<sub>k</sub>**- paraqet variablën e pavarur,

**B<sub>k</sub>**- paraqet koeficientin,

**U<sub>it</sub>**- paraqet gabimin,

**e<sub>n</sub>**- paraqet subjektet të cilat janë në numra (dummies) apo binare, n-1 paraqet subjekte të përfshira në model,

**γ<sub>2</sub>**- paraqet koeficientin binar.

Këto ekuacione janë ekuivalente me njëra tjetren, në ekuacionin më sipërm të dhënat kanë të njëjtin burim, ku paraqitet një ndryshore e pashënuar e cila ndryshon në të gjitha entitetet që janë të përfshira në model.

#### 4.6 MODELI RANDOM EFFECTS

Modelet e efektit të rastësishëm ndihmojnë në kontrollin e heterogjenit të pambrojtur, kur heterogjeni është konstant me kalimin e kohës dhe nuk lidhet me variablën e pavarur. Kjo konstante mund të hiqet nga të dhënat përmes diferencimit, ku në çdo kohë do të eliminojmë komponentat apo përberësit të pandryshueshëm në model.

Kemi dy supozime sa i përket efektit specifik individual:

- Supozimin e efekteve të rastit dhe
- Supozimin e efekteve fikse

Supozimi i efekteve të rastit është që heterogjeni i paobservuar individual është i palidhur me variablat e pavarura ndërsa supozimi i efekteve fikse është se efekti specifik individual është i lidhur me variablat e pavarura.

Ekuacioni i modelit të efekteve të rastësishme është si vijon:

$$x = Y\beta + \varepsilon_{it}$$

prej ku:

$$\varepsilon_{it} = \alpha_i + \eta_{it}$$

Për dallim nga modeli “Fixed Effects” në këtë model vlen të theksohet se ekziston pandryshueshmëria e kohës në efektet specifike në entitetet e ndryshme, që do të thote se  $\alpha_i$  nuk është në korelacion me  $x_{it}$ .

Gjithashtu është e nevojshme të jetë sa më e qartë lidhja me dy pjeset e “termit error”:

$$E[\eta_{it} | Y] = E[\alpha_i | Y] = 0$$

$$E[\eta_{it} | Y] = \sigma_\eta,$$

$$E[\alpha_i | Y] = \sigma_\alpha,$$

$$E[\alpha_i | Y] = 0, \eta, \text{ për të gjitha } i, t, j.$$

$$E[\alpha_i | \alpha_j | Y] = 0, \text{ për } 'i \neq j'.$$

Në këtë model duhet cekur që, (**t**) observacionet në (**n**) shtete nuk janë identike si observacionet në “nt” të shteteve apo vendeve të ndryshme.

Në qoftë se  $\sigma_\eta$  dhe  $\sigma_\alpha$  dihen, atëherë vlersuesi ‘GLS’, gjegjësisht Random effects mund të zbatohet pa vështirësi, por është e pamundur sepse vlersimet e variancës e cila është e panjohur është tejet e nevojshme.

E rëndësishme të ceket që ndryshoret “time-invariant” nuk kanë qasje të përdoren për shkak se, gabimi në matje të ‘X’ si dhe ndryshoret të cilat janë endogjene në ‘X’ mund të paraqiten si rezultate të njëanshme. Mund të cekim që as vlersuesi “Random Effects” e as “Fixed Effects” nuk janë të përshtatshme, modelet tjera që janë më të sofistikuara që mund të aplikohen janë “GMM-Generalized Method of Moments” ose “IV- Instrumental Variabel”.

Disa nga variablat e pavarura (shpjeguese) të cilat janë përdorur në këtë hulumtim, të cilat supozohen të jenë endogjene, ndërsa modelet “Random Effects” dhe “Fixed Effects” janë përdorur vetëm për qëllime krahasimore, ndërsa modeli i cili është më i avancuar është përdorur modeli “Hausman Taylor-IV” i cili do të trajtohet në vijim.

#### 4.7 HAUSMAN TAYLOR IV

Taylor dhe Hausman (1981) paraqitën një model të ri, i cili ndërthur të dy efektet si “Fixed Effects” ashtu edhe “Random Effects”, pikërisht ky model ndihmon për të kaluar vështësitë që përdoruesi duhet të ndërmarrë, kur zgjedhim nëse efektet specifike individuale janë të lidhura ose jo të lidhura me grupin e variablave shpjeguese. Egzistojnë dy kufizime të rëndësishme:

- Nëse ka lidhje ose jo
- Nëse supozohet që efektet specifike individuale janë të lidhura me variablat shpjeguese, më pas ne nuk mund që të vlersojmë invariantin kohor të variablave shpjeguese.

Modeli mund të shkruhet si:

$$X_{it} = Y_{it} + \beta + Z_i X + \alpha_i + n_i$$

Ku  $Z_i$  janë ndryshoret apo variablat që ndryshojnë përgjat kohës, përkatesisht të gjitha efektet individuale, të cilat janë përfshirë në  $Z_i$  dhe janë të observuara.

Hausman dhe Taylor përcaktojnë që të bëhet ndarja  $Y$  dhe  $Z$  në dy grupe të ndryshoreve  $Y=[Y1;Y2]$  dhe  $Z=[Z1;Z2]$   $Y1$  është “  $nyk1$ ,  $Y2$  është “  $nyk2$ ,  $Z1$  është “  $nyg1$ ,  $Z2$  është “  $nyg2$ ” dhe  $n-NT$

Modeli mund të shkruhet si:

$$X_{it} = Y_{1it} + \beta_1 + Y_{2it} + \alpha_i + Z_{1it} X + Z_{2it} X_2 + \alpha_i + n_{it}$$

Në modelin e me sipërm e llojit dallues i këtij modeli gjendet tek supozimet mbi korelacionin nëpërmjet efekteve individuale-specifike  $\alpha_i$  dhe grupe të regresoreve që nuk variojnë dhe variojnë. Ky model përcakton katër grupe të variablave të observuara të cilat janë:

**Y1it** paraqet **k1** kjo variabël varionë përgjat kohës dhe nuk është në korrelacion me **ai** ,

**Z1i** paraqet variablën e cila nuk është në korrelacion me **ai** , nuk varionë përgjatë kohës.

**Y2it** e njejta është në korrelacion me **ai** dhe paraqet variablën e cila varionë përgjatë kohës,

**Z2i** është në korrelacion me **ai** dhe paraqet variablën e cila nuk varionë.

Ky model është gjithmonë efikas dhe konsistent, e cila dallon nga qasjet tjera për arsye se këtu nuk duhet të përdoren instrumentet e jashtme.

Strategjia e Hausman Taylor është të përdorim ndryshoret problematike siç i kemi 'Y2it' dhe 'Z2i' ku u propozua qasja e 'IV- Instrumental variable' ku ndryshoret në vijim janë përdorur si instrumente : 'Y1it', 'Z1i', 'Y2it', 'Z2it'.variablat që nuk janë në korrelacion apo ato ekzogjene me  $\alpha_i$  shërbejnë si instrumente.

Modeli që është më efikas dhe konsistent është modeli i propozuar nga Hausman dhe Taylor, këtu nuk përdoren instrumente të jashtme në të cilën paraqet një avantazh të fortë, për këtë shkak kjo qasje dallon nga qasjet e tjera.

#### **4.8 DALLIMI I MODELEVE FIXED EFFECTS , RANDOM EFFECTS, HAUSMAN TAYLOR**

Alternativa më efektive në mes efekteve të rastit dhe efekteve të rastësishme është kur e përdorim Hausman test. Hausman test (1978) është mënyra më e mirë midis dy efekteve të cilët janë Fixed effects dhe Random effects, gjithashtu ky test bën testimin e hipotezave të emëruara nga Jerry A.Hausman, pikërisht ky test arrinë që të bën vlersimin e significancës së një preventivuesi kundrejt një tjetri. Krahas kësaj ky test bën testimin e hipotezes zero të koeficienteve të vlersuar nga preventivuesi më kosistent "Fixed effects" në të cilën janë identike me ato të vlersuara nga preventivuesi më efikas "Random effects". Nëse ky test jep rezultate më P-vlera insignifikante ku 'Prob>ch2' më e madhe se '.05' , në këtë rast më efektive është të përdoret modeli i "Random effects" dhe në rastë se i njejti test jep rezultate që janë signifikante atëherë në këtë rast duhet të përdorim modelin "Fixed effects".

Sipas të gjithave mund të themi që Hausman test teston hipotezen zero dhe mundëson që të analizojmë se cili nga modelet është më efikas apo më pak efikas. Në menyrë statistike modeli Fixed effects gjithmonë jep rezultate të qëndrueshme, por mund mos jetë modeli më efikas ndërsa sa i perket Random effects është më efikas dhe do të jep p=vlera më të mira. Hausman-Taylor është më efikas dhe konsistent, ku paraqet zgjedhjen më të mirë në qoftë se e krahasojmë me modelet e efekteve fikse dhe ato te rastit.

Si konkludim Hausman test përdoret për të krahasuar dhe kontrolluar efikasitetin në mes modeleve, se cili model është më efikas kundrejt modelit tjetër, modeli që paraqitet si më efikas ai model jep rezultate më të qëndrueshme.

#### **4.9 MODELI EMPIRIK**

Gjat këtij hulumtimi, kam përdorur modelin 'Hausman Taylor' i cili ka për qëllim për të vlersuar ndikimin e variablave në pabarazinë ekonomike, gjithashtu duke u bazuar në rezultatet e fituara nga modelet Fixed Effects, Random Effects si dhe Hausman test në të cilën arrijmë në përfundim se modeli më i përshtatshëm në këtë punim shkencor është modeli Hausman dhe Taylor IV.

Gjat specifikimit të modelit ekonometrik, si variabla të pavarura do të konsiderohen subvencionet dhe transferet (subs\_and\_transf), indeksi i çmimeve të konsumit (fconsmp\_coef), shpenzimet qeveritare (gov\_expendgdp), indeksi i korrupsionit (corrup\_index), të ardhurat publike (public\_rev\_gdp) ndërsa si variabël të varur e kam vendosur koeficientin e Gin-it në njëren alternativë dhe rritjes ekonomike në alternativën tjetër.

Si model bazë në këtë punim shkencor do të zgjedhim Hausman-Taylor, gjithashtu do të paraqes edhe rezultatet e fituara nga modelet "Random Effects", dhe "Fixed Effects". Në bazë përdorimit të këtyre dy modeleve, përmes Hausman Test do të mund të realizojë krahasimin e rezultateve të metodës "Fixed Effects", e cila është më konsistente, me rezultatet e metodës "Random Effects" ku është më efikas.

Në vazhdim do të specifikojmë modelin Hausman-Taylor, ku do të shërbejë për të përlllogaritur koeficientet të cilët do të pohojnë ose hudhin hipotezat tona: Specifikimi i modelit është paraqitur në vijim:

$$Gin.index=A1+A2(Shpenzime.Qeveritare)+A3(Subvencionet.Transferat)+A4(Groëth_r$$



*ate)+(Indeksi.Korrupsionit)+A5(Ardhurat.Publike)+u*

*Groëth\_rate=A1+A2(Shpenzime.Qeveritare)+A3(Subvencionet.Transferat+A4(Gin.inde  
x)+(Indeksi.Korrupsionit)+A5(Ardhurat.Publike)+u*

## **5. TESTIMI I DETERMINANTAVE TË GIN INDEXIT DHE RRITJES EKONOMIKE**

Ne këtë kapitull si model primar do të zgjedhim modelin e Hausman-Taylor ku do të jepen fakte se kjo metodë është zgjedhja më e mirë në krahasim me modelet e “Fixed Effects” dhe “Random Effects” gjithashtu do të paraqes dhe rezultatet e fituara nga këto dy modele.

Në bazë rezultatit të Hausman Test vijmë në konstatim se “Random Effects” nuk paraqitet si konsistent për arsye se ka korelacion në mes termit error dhe variablave, vijmë në konkludim se preventivuesi “Fixed Effects” paraqitet si zgjedhja më e mirë.

Duhet cekur që problemet e endogjenitetit janë kudo në të dhenat e përdorura, në të cilën kam zgjedhur metoden Hausman-Taylor si metode e cila do ti shmangë këto probleme duke përdorur një test të dytë, me qëllim që të bëhet krahasimi në mes Hausman-Taylor dhe Fixed Effects. Në fund duke u bazuar nga dy alternativat e propozuara vijmë në konkludim se metoda “Hausman-Taylor-IV” paraqitet si zgjedhja më e mirë dhe më e përshtatshme.

## 5.1 INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Në vijim do të paraqesim rezultatet e OLS me gabim standard të besueshëm, Random Effects, Fixed Effects dhe si model bazë do të zgjedhim Hausman-Taylor, gjithashtu Hausman-Taylor zgjedh problemin e endogjenitetit i cili është tejte i rëndësishëm në analizimin e metodës së katroreve të vegjël. Më pas do të paraqiten rezultatet e modelin ekonometrik si dhe analiza e të dhënave (Shih në appendix B).

*Tabela 5.1 Testimi i determinantave të Gin index në vendet e tranzicionit*

Variables	OLS	Fixed effects	Random effects	HausmanTaylor-IV
<i>gini_coef</i>				
<i>fconsmp_coef</i>	-1.1441836	-.4155313	-.422484	-.3877691
<i>gov_expendgdp</i>	-2.108303	.2298482	.16047	.1793724
<i>subs_and_transf</i>	-.1963023	-.1172821	-.1184476	-.1340512
<i>groëth_rate</i>	-.4187307	-.1377778	-.148437	-.1549144
<i>corrup_index</i>	-.3310938	-.0844119	-.0879617	-.0803462
<i>public_revsgdp</i>	-.0155794	-.4879105	-.4567091	-.4031934
<i>_cons</i>	131.7857	93.62611	95.54142	114.8435
<i>Observations</i>	86	86	86	86
<i>R-Squared</i>	0.5209			
<i>F</i>	14.32	4.68		
<i>Chi2</i>	N/A	N/A	28.81	45.02
<i>Model</i>	OLS	FE	RE	HT-IV

**Burimi:** Kalkulim nga autori, Shënim: (\*) 5% niveli i signifkancës statistikore, (\*\*) 10% niveli i signifkancës statistikore.

Në bazë rezultateve të regresionit dhe modeleve si “Fixed Effects”, “Random Effects” dhe testit “Hausman Taylor”, arrijmë në konkludim se rritja eventuale e subvencioneve dhe transferave për 1% do të shkaktojë ulje në koeficientin e Gin-it për **-0.13%**, **ceteris paribus**. Meqë se edhe Standard Error është (se)=0.05, 0.055 tek Fixed Effect dhe 0.054 tek Random Effect, në bazë kësaj sa më e ulët të jetë (se) ky koeficient aq më shumë ka signifkance rezultati i fituar. Në bazë këtyre parametrave të fituar duke marrë parasysh koeficientin e standard errorr-it i cili duhet të jetë më i vogël se 0.05 që rezultati të ketë besueshmeri, në

rastin tonë konkret shohim që rezultatet tona paraqesin një rezultat të besueshëm. Gjithashtu nga kjo konkludojme se rritja e subvencioneve dhe transferave në vendet e tranzicionit ndikon drejtpërdrejtë në uljen e pabarazise në këto vende. Prandaj në bazë këtij rezultati ne e vërtetojmë hipotezën e parashtruar në fillim të punimit e cila pohon se: **H1/1.Subvencionet dhe transferet ndikojnë pozitivisht në uljen e GIN – indexit.**

Krahas kësaj në këtë model ekonometrik si variabël tjetër e cila është tejet e rëndësishme është norma e rritjes ekonomike dhe në bazë analizes së regresionit, “Fixed Effect”, “Random Effect” dhe testi “Hausman Taylor”, rezultati i paraqitur në bazë analizës tregon se nëse kemi rritje për 1% të rritjes ekonomike apo GDP-se kjo do të afektojë ulje të Gin-it apo pabarazisë për **-0.15, ceteris paribus**. Standard error tregon që është (se)=0.065, 0.064 tek Random Effect, dhe 0.065 tek Fixed Effect.

*Tabela 5.2 Testimi i determinantave të rritjes ekonomike në vendet e tranzicionit*

Variables	OLS	Fixed effects	Random effects	Hausman Taylor-IV
<i>Groëth_rate</i>				
<i>fconsump_coef</i>	.10001	.0271279	.10001	.0367128
<i>gov_expendgdp</i>	-.5721311	-1.802646	-.5721311	-1.425911
<i>subs_and_transf</i>	-.0480723	-.1460599	-.0480723	-.1898642
<i>Gini_coef</i>	-.0570707	-.4221238	-.0570707	-.5134185
<i>corrup_index</i>	.0136851	-.1732761	.0136851	-.1452039
<i>public_revvgdp</i>	-.1089799	-.0793218	-.1089799	-.1692095
<i>_cons</i>	17.33255	77.39312	17.33255	85.05302
<i>Observations</i>	86	86	86	86
<i>R-Squared</i>	0.1558			
<i>F</i>	2.43	8.37		
<i>Chi2</i>	N/A	N/A	14.58	47.43
<i>Model</i>	OLS	FE	RE	HT-IV

**Burimi:** Kalkulim nga autori, Shënim: (\*) 5% niveli i signifkancës statistikore, (\*\*) 10% niveli i signifkancës statistikore.

Në tabelën (5.1) si variabël e varur ishte Gin indexi, ndërsa tek tabela (5.2) koeficienti i Gin-it paraqitet si variabël e pavarur ndërsa rritja ekonomike si variabël e varur, ku do të shohim se si ndikon pabarazia në normën e rritjes ekonomike dhe e kundërta si GDP-ja ndikon në

indeksin e Gin-it.

Në bazë rezultateve të regresionit dhe modeleve si “Fixed Effects”, “Random Effects” dhe testit “Hausman Taylor”, shohim që rritja e Gin-indexit për 1% do të shkaktojë ulje të rritjes ekonomike për **-0.057%**, prandaj në bazë këtij rezultati ne e vërtetojmë hipotezën e parashtruar në fillim të punimit e cila pohon se: **H1/2.Reduktimi i pabarazise ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike**, që domethënë çdo rritje e pabarazisë do të ndikon në rritjen e GDP-së. (Paul Krugman, 2014), në hulumtimet e tij arrinë në perfundim se pabarazia pengon rritjen ekonomike.

Gjithashtu, si variabël të dytë që është e rëndësishme e kemi subvencionet dhe transferat, në bazë rezultateve të regresionit dhe modeleve, shohim se çdo rritje e subvencioneve dhe transferave për 1% do të shkaktojë ulje në rritjen ekonomike për **-0.189%**, **ceteris paribus**, duhet cekur që subvencionet paraqiten në forma të ndryshme të ndihmave sociale si: shëndetësi falas, individë që u mundësojnë të kenë të ardhura po që se ato nuk i disponojne fare, mbrojtje sociale për pleq dhe fëmije, bursa të ndryshme etj, ku shpenzimet publike u dedikohen subvencioneve dhe transfertave sociale.

## 6. PËRFUNDIMI

Objektivi kryesor i këtij hulumtimi është që të identifikojë raportin në mes pabarazisë ekonomike dhe rritjes ekonomike si dhe determinatat e saja, në periudhën kohore 2009-2018, në vendet në tranzicion. Ky hulumtim ngreh në pah dy pyetje hulumtuese ku jepen përgjigje nëpërmjet hipotezave të parashtruara në hyrjen e këtij punimi. Në fillim është analizuar determinatat që ndikojnë në uljen e GINI indeksit dhe pastaj si kjo pabarazi e matur nëpërmjet GINI indeksit ndikon në rritjen ekonomike. Determinatat kryesore të inkuadruara në model empirik janë subvencionet dhe transferet, kurse si variabla kontrolluese që janë përfshirë në model janë shpenzimet qeveritare, të ardhurave publike, indeksin e korrupsioni dhe indeksi i çmimeve të konsumit ose inflacioni.

Në verifikimin e validitetit të hipotezave kam përdorur metoda ekonometrike të sofistikuara me qëllim që të japim një rezultat të besueshëm si të tilla: Pooled OLS, Fixed Effects, Random Effects si dhe Hausman Taylor-IV. Rezultatet empirike nga modeli i vlersuar tregojnë se çdo ulje e pabarazisë ndikon drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike, ceteris paribus, dhe si rrjedhim në bazë këtij rezultati ne e mbështesim hipotezën e parë të vendosur në fillim të këtij punimi shkencor e cila pohon se **H1/1 reduktimi i pabarazisë ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike**. Gjithashtu rezultatet tona tregojnë se çdo rritje e subvencioneve dhe transferave do të ndikojë në uljen e Gin-it indeksit, ku në bazë këtij rezultati ne e mbështesim hipotezën e dytë e cila pohon se **H1/2 subvencionet dhe transferat ndikojnë pozitivisht në uljen e Gin-indeksit**.

Në fund mund konkludojmë se ky punim mund t'ju shërbejë Qeverive të vendeve në tranzicion që të ndërmarin masa në kuadër të politikës ekonomike qeveritare që të zvoglojnë pabarazinë ekonomike në funksion të rritjes ekonomike dhe mirëqenjes në tërësi. Çdo politikë ekonomike që e thellon hendekun ndërmjet pabarazisë ekonomike mund të llogaritet si politikë “vetvrasëse” të vendeve në tranzicion.

Si çdo hulumtim shkencor tjetër edhe ky hulumtim ka limitimet/dobitë e veta pasi që nuk janë të përfshira ca variabla tjera të rëndësishme si për shembull, puna, kapitali, investimet e huaja direkte, papunësia, ndikimi i kursimeve, etj.



## 7. LITERATURA- REFERENCAT

1. Cancado, P.L. (2005), 'Economic Growth: Panel Data Evidence from Latin America', Center for International Studies, (53pp) Cestone, G & L. Ehte. (2003), "Anticompetitive Financial Contracting: The Design of Financial Claims." Journal of Finance, Vol. 58, No. 5, pp. 2109-2142, October 2003.
2. Banka Boterore, GDP growth (annual %), <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.KD.ZG>
3. Banka Boterore, Subsidies and other transfers (% of expense), <https://data.worldbank.org/indicator/GC.XPN.TRFT.ZS>
4. General government final consumption expenditure (% of GDP), <https://data.worldbank.org/indicator/NE.CON.GOVV.ZS>
5. Banka Boterore, Consumer price index, <https://data.worldbank.org/indicator/FP.CPI.TOTL>
6. GINI index (World Bank estimate), <https://data.worldbank.org/indicator/SI.POV.GINI>
7. Atkinson, Anthony B.; Piketty, Thomas (2010). Top incomes: a global perspective. Oxford New York.
8. Atkinson, Anthony B. (2014). Inequality: What Can Be Done?. Harvard University Press. p. 384
9. Bošković Branko, 2015: Globalizacija i nejednakosti – budućnost mladi u Evropi "IDN Beograd.
10. Berg, A. Ostry, J. D. and Zettelmeyer, 2012: "What Makes Growth Sustain?" Journal of Development Economics, Vol. 98(2), pp. 149-66.
11. Christensen, Ronald (2002). Plane Answers to Complex Questions: The Theory of Linear Models (Third ed.)
12. Ricardo, David (1817) On the Principles of Political Economy and Taxation. Piero Sraffa (Ed.) Works and Correspondence of David Ricardo, Volume I, Cambridge University Press, 1951, p. 11

13. Davies Hoëord, 2015: "Rritja e pabarazive ekonomike, represioni financiar mbi kursimet, shpërndarja e pabarabart e pasurisë" Project Syndicate, përkthim shqip.
14. John Kenneth Galbraith, "The Economist" May 4, (2006). Retrieved July 3, 2013
15. DeLong, J. Bradford, 2017: "Në fushën e rishqyrtimit të rritjes së prodhimit", project syndicate, përkthim shqip.
16. Atkinson, Anthony B. (1983). "The economics of inequality"
17. Taylor, E. J. (1981). "Panel Data and Unobservable Individual Effects" *Econometrica*.
18. Fetaj Besnik, 2013: "Assessing monetary and Fiscal Policy interaction in a small open economy the Case Republic of Macedonia, Transit Stud ,Reë, South East European Issues.
19. Fetaj Besnik, 2014: "The effect of Financial Integration and Financial Development on Economic Growth during the Financial Crisis", *Empirical Economic Letters* 13(3)37-50. .
20. Fetaj Besnik and Mustafi Besime, 2017: "An Empirical Analysis the Determinants Economic Growth in the Western Balkans .
21. Gabrisch, H. 2015: Financial Constraints on Growth Comparing the Balkans to other Transition, *Economies Eastern Europe Economics*, 53(4) pp 30-37
22. Hausman, R., 2015: "A shkakton kapitalizimi varfëri", Project Syndicate, përkthim Shqip.
23. Hausman, R., Rodrik, D and Velasco, A., 2005: "Growth Diagnostic" John F.
24. Kennedy School of Government "Cambridge, Massachusetts, Harvard University.
25. Diggle, Peter J.; Heagerty, Patrick; Liang, Kung-Yee; Zeger, Scott L. (2002). *Analysis of Longitudinal Data* (2nd ed.). Oxford University Press. pp. 169–171.
26. Krasniqi Besnik and Desai Sameeksha 2016 "Institutional drivers of high-growth firms country-level evidence from 26 transition economies ,small bus .Econ
27. Luiz de Mello and Tiongson, R. Ervin 2003: "Income Inequality and Redistributive Government Spending" IMF Working Paper.
28. Moyo Dombisa, 2016: "Enigma e pabarazisë" Project Syndicate, përkthim Shqip .



29. Novaković Nada, 2015: "Globalizacija društvene nejednakosti, socijalni potresi" IDN Beograd.
30. Ostry, D.J., Berg, A. and Tsngarids, G. Ch: 2014 "Redistribution Inequality and Growth" IMF .
31. Piketty Thomas, 2013, Paris , botimi anglisht 2014.: "Capital in the Twenty-first century".
32. Rajan .R., 2010: "Foult Lines hoë :Hidden Fractures:Threaten the ëorld Ekonomie", Prinseton University Press.
33. Stiglitz. E. Joseph, 2010: "Freefall-Free Markets and the Siking of the ëorld Economy" Narton & Company, Neë York.
34. Stiglitz, E. Joseph, 2013: "The Price of inequality Hoë Today's Divided Society Endangers Our Future", ëë. Narton & Company, Neë York.
35. Stiglitz, Joseph E.; Greenëald, Bruce C. (May 1986). "Externalities in economies ëith imperfect information and incomplete markets"
36. Barro, Robert J.; Sala-i-Martin, Xavier (2004). Economic Growth (2nd ed.). Cambridge: MIT Press. pp. 212–20.
37. ëooldridge, Jeffrey M. (2013). "Fixed Effects Estimation". Introductory Econometrics: A Modern Approach (Fifth international ed.). Mason, OH: South-ëestern. pp. 466–474..
38. Šuković Danilo, 2013: "Ljudski Kapital ,Ekonomski Rast i nejednakosti", IDN, Beograd.
39. Šuković Danilo, 2014: "Neoliberalizam na udaru nejednakosti i glomazne države", IDN, Beograd.
40. Griliches, Zvi (1986). "Errors in Variables in Panel Data"
41. Piketty, Thomas (13 February 2017). "For a credible and bold basic income". Le blog de Thomas Piketty. Retrieved 13 March 2017.
42. Hsiao, Cheng (2003). "Fixed-effects models". Analysis of Panel Data (2nd ed.). Neë York: Cambridge University Press. pp. 95–103.
44. Villiams, C. & Krasniqi .B. , 2017 : "Evaluating the individual - and country-level variations in tax morale evidence from 35 Eurasian Coutries", Journal of ekonomie studies .

45. Gujarati, Damodar N.; Porter, Daen C. (2009). "Panel Data Regression Models". Basic Econometrics (Fifth international ed.). Boston: McGraw-Hill. pp. 591–616.
46. Zhuang Juzhang , Emanuel . de Dios and Anneli Lagman – Martin, 2010:”Governance and Institutional Quality and the Links Between Economic Growth and Income Inequality with special reference to developing Asia”,ADB Economics Working paper series.
47. “Beyond “Fixed Versus Random Effects”: A framework for improving substantive and statistical analysis of panel, time-series cross-sectional, and multilevel data” / Brandon
48. Data analysis using regression and multilevel/hierarchical models / Andrew Gelman, Jennifer Hill. Cambridge ; New York : Cambridge University Press, 2007.
49. Data Analysis Using Stata/ Ulrich Kohler, Frauke Kreuter, 2nd ed., Stata Press, 2009.
50. Statistics with Stata (updated for version 9) / Lawrence Hamilton, Thomson Books/Cole, 2006.



## 7.1 LLOGARITJA NË APPENDIX

### Appendix.A

*Tabela A1. Vendet e përfshira në modelin empirik*

Nr	Vendet e analizuara
1	Shqipëria
2	Maqedonia e Veriut
3	Sërbia
4	Kosova
5	Polonia
6	Hungaria
7	Republika Çeke
8	Rusia
9	Estonia

*Tabela A2. Përshkrimi i Variablave*

Nr.	Variablat:	Detaje:	Kodi:
1	Shpenzimet qeveritare	Shpenzimet qeveritare të shprehura në % GDP	gov_expendgdp
2	Korrupsioni	Indeksi i faktorëve institucional (korrupsioni)	corrup_index
3	Të ardhurat publike	Të ardhurat publike të shprehura në % GDP	public_revdp
4	Subvencionet dhe Transferat	Subvencionet dhe transferat tjera si % e shpenzimeve	subs_and_transf
5	Koeficienti Gin	Koeficienti që mat Pabarazinë	gini_coef
6	Rritja Ekonomike	Rritja ekonomike, PBB-ja për kokë banori	groëth_rate
7	Indeksi i çmimit të konsumit	Konsumi final	fconsmp_coef

## 7.2Appendix B.

### OLS-1

```
. regress gini_coef fconsmp_coef gov_expendgdp subs_and_transf groeth_rate  
corrup_index public_revgrp
```

Source	SS	df	MS	Number of obs	=	86
-----+-----				F(6, 79)	=	14.32
Model	8066.88232	6	1344.48039	Prob > F	=	0.0000
Residual	7419.3622	79	93.9159772	R-squared	=	0.5209
-----+-----				Adj R-squared	=	0.4845
Total	15486.2445	85	182.191112	Root MSE	=	9.691

gini_coef	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
-----+-----						
fconsmp_coef	-.1441836	.2142097	-0.67	0.503	-.5705574	.2821901
gov_expendgdp	-2.108303	.4426015	-4.76	0.000	-2.989279	-1.227326
subs_and_transf	-.1963023	.118601	-1.66	0.102	-.4323716	.039767
groeth_rate	-.4187307	.3010892	-1.39	0.168	-1.018034	.1805722
corrup_index	-.3310938	.1131887	-2.93	0.004	-.5563903	-.1057973
public_revgrp	-.0155794	.257932	-0.06	0.952	-.5289803	.4978214
_cons	131.7857	12.60819	10.45	0.000	106.6898	156.8817

---

## OLS 2

```
regress groëth_rate fconsm_p_coef gov_expendgdp subs_and_transf gini_coef corrup_index
public_rev_gdp
```

Source	SS	df	MS	Number of obs	=	86
-----+-----				F(6, 79)	=	2.43
Model	186.599314	6	31.0998857	Prob > F	=	0.0331
Residual	1011.21801	79	12.8002279	R-squared	=	0.1558
-----+-----				Adj R-squared	=	0.0917
Total	1197.81732	85	14.0919685	Root MSE	=	3.5777

groëth_rate	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
fconsm_p_coef	.10001	.0785063	1.27	0.206	-.0562528	.2562729
gov_expendgdp	-.5721311	.1738525	-3.29	0.001	-.9181759	-.2260863
subs_and_transf	-.0480723	.0442083	-1.09	0.280	-.1360667	.0399221
gini_coef	-.0570707	.0410368	-1.39	0.168	-.1387524	.024611
corrup_index	.0136851	.043965	0.31	0.756	-.073825	.1011951
public_rev_gdp	-.1089799	.0944331	-1.15	0.252	-.2969442	.0789844
_cons	17.33255	6.915683	2.51	0.014	3.567223	31.09787

## Fixed Effects 1

```
. xtreg gini_coef fconsmp_coef gov_expendgdp subs_and_transf groeth_rate corrup_index
public_revvgdp, fe
```

```
Fixed-effects (äithin) regression          Number of obs   =          86
Group variable: cod                       Number of groups =          9
```

```
R-sq:                                     Obs per group:
äithin = 0.2834                            min =          6
  between = 0.0288                          avg =          9.6
  overall = 0.0143                          max =          10
```

```
corr(u_i, Xb) = -0.1642                    F(6,71)         =          4.68
                                                Prob > F        =          0.0005
```

gini_coef	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
fconsmp_coef	-.4155313	.1734943	-2.40	0.019	-.7614692	-.0695935
gov_expendgdp	.2298482	.278322	0.83	0.412	-.32511	.7848064
subs_and_transf	-.1172821	.0555387	-2.11	0.038	-.2280231	-.0065411
groeth_rate	-.1377778	.0658005	-2.09	0.040	-.2689803	-.0065753
corrup_index	-.0844119	.0413155	-2.04	0.045	-.1667927	-.0020311
public_revvgdp	-.4879105	.1822285	-2.68	0.009	-.8512637	-.1245573
_cons	93.62611	9.237948	10.13	0.000	75.20616	112.0461
sigma_u	14.59028					
sigma_e	1.7331742					
rho	.98608537	(fraction of variance due to u_i)				

```
F test that all u_i=0: F(8, 71) = 299.86          Prob > F = 0.0000
```

## Fixed Effect 2.

```
xtreg  groëth_rate  fconsmp_coef  gov_expendgdp  subs_and_transf  gini_coef  corrup_index
public_revsgdp, fe
```

```
Fixed-effects (ëithin) regression          Number of obs   =          86
Group variable: cod                       Number of groups =           9
```

```
R-sq:                                     Obs per group:
ëithin = 0.4142                            min =           6
  between = 0.0474                          avg  =          9.6
  overall = 0.1084                          max  =          10
```

```
corr(u_i, Xb) = -0.8768                    F(6,71)         =          8.37
                                                Prob > F        =          0.0000
```

```
-----+-----
```

groëth_rate	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
fconsmp_coef	.0271279	.3156926	0.09	0.932	-.6023453	.6566011
gov_expendgdp	-1.802646	.4402763	-4.09	0.000	-2.680532	-.9247602
subs_and_transf	-.1460599	.0987093	-1.48	0.143	-.3428807	.0507609
gini_coef	-.4221238	.2015997	-2.09	0.040	-.8241022	-.0201454
corrup_index	-.1732761	.0715152	-2.42	0.018	-.3158733	-.0306789
public_revsgdp	-.0793218	.334551	-0.24	0.813	-.7463975	.5877538
_cons	77.39312	23.56623	3.28	0.002	30.4034	124.3828

```
-----+-----
```

sigma_u	4.7569751
sigma_e	3.0336994
rho	.71087929 (fraction of variance due to u_i)

```
-----+-----
```

```
F test that all u_i=0: F(8, 71) = 4.86          Prob > F = 0.0001
```



## Random Effects 1.

```
. xtreg gini_coef fconsmp_coef gov_expendgdp subs_and_transf groeth_rate corrup_index  
public_revgrp, re
```

```
Random-effects GLS regression           Number of obs   =           86  
Group variable: cod                    Number of groups =           9
```

```
R-sq:                                     Obs per group:  
within = 0.2823                          min =           6  
between = 0.0521                          avg =          9.6  
overall = 0.0299                          max =          10
```

```
Wald chi2(6) = 28.81  
corr(u_i, X) = 0 (assumed)                Prob > chi2 = 0.0001
```

```
-----+-----  
      gini_coef |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]  
-----+-----  
      fconsmp_coef |   -.422484   .1696236   -2.49   0.013   - .7549402   - .0900277  
      gov_expendgdp |    .16047   .2725642    0.59   0.556   - .3737459   .6946859  
      subs_and_transf |  -.1184476   .0547519   -2.16   0.031   - .2257594   - .0111359  
      groeth_rate |   -.148437   .0649982   -2.28   0.022   - .2758311   - .0210429  
      corrup_index |  -.0879617   .0405344   -2.17   0.030   - .1674077   - .0085157  
      public_revgrp |  -.4567091   .1757614   -2.60   0.009   - .8011951   - .1122231  
      _cons |    95.54142  10.41566    9.17   0.000    75.12711   115.9557  
-----+-----  
      sigma_u |  15.861725  
      sigma_e |   1.7331742  
      rho |   .98820144   (fraction of variance due to u_i)
```

## Random Effect 2.

```
xtreg  groëth_rate  fconsmp_coef  gov_expendgdp  subs_and_transf  gini_coef  corrup_index
public_revvgdp, re
```

```
Random-effects GLS regression           Number of obs   =           86
Group variable: cod                    Number of groups =           9
```

```
R-sq:                                Obs per group:
äithin = 0.2888                        min =           6
    betëeen = 0.4198                    avg =           9.6
    overall = 0.1558                    max =           10
```

```
Äald chi2(6)      =      14.58
corr(u_i, X)     = 0 (assumed)          Prob > chi2      =      0.0238
```

groëth_rate	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
fconsmp_coef	.10001	.0785063	1.27	0.203	-.0538595	.2538796
gov_expendgdp	-.5721311	.1738525	-3.29	0.001	-.9128758	-.2313864
subs_and_transf	-.0480723	.0442083	-1.09	0.277	-.1347189	.0385744
gini_coef	-.0570707	.0410368	-1.39	0.164	-.1375013	.0233599
corrup_index	.0136851	.043965	0.31	0.756	-.0724847	.0998548
public_revvgdp	-.1089799	.0944331	-1.15	0.248	-.2940653	.0761055
_cons	17.33255	6.915683	2.51	0.012	3.778056	30.88704
sigma_u	0					
sigma_e	3.0336994					
rho	0	(fraction of variance due to u_i)				

## Modeli pëfundimtar për komentim të rezultateve.

### Modeli Hausman Taylor-IV

#### Hausman Taylor 1

```
. xtaylor gini_coef fconsmp_coef gov_expendgdp subs_and_transf groeth_rate corrup_index  
public_rev~p cod, endog ( gini_coef groeth_rate)
```

```
Hausman-Taylor estimation      Number of obs   =      86  
Group variable: cod           Number of groups =      9
```

```
Obs per group:  
      min =      6  
      avg =     9.6  
      max =     10
```

```
Random effects u_i ~ i.i.d.    Wald chi2(7)    =     45.02  
                               Prob > chi2       =     0.0000
```

```
-----+-----  
      gini_coef |      Coef.   Std. Err.   z   P>|z|   [95% Conf. Interval]  
-----+-----  
TVexogenous |  
fconsmp_coef |  -.3877691   .1678518   -2.31  0.021   -.7167526   -.0587856  
gov_expend~p |  .1793724   .2745029    0.65  0.513   -.3586433    .7173882  
subs_and_t~f |  -.1340512   .0550339   -2.44  0.015   -.2419157   -.0261868  
corrup_index |  -.0803462   .0406096   -1.98  0.048   -.1599396   -.0007528  
public_rev~p |  -.4031934   .1680436   -2.40  0.016   -.7325527   -.0738341  
TVendogenous |  
groeth_rate |  -.1549144   .0658378   -2.35  0.019   -.283954    -.0258747  
TIexogenous |  
      cod |  -4.283706   1.109344   -3.86  0.000   -6.457979   -2.109433  
      |  
      _cons |  114.8435    10.16824   11.29  0.000    94.91408    134.7728  
-----+-----  
sigma_u |  7.9725719  
sigma_e |  1.6642786  
rho |  .95824286 (fraction of variance due to u_i)--more--
```

## Hausman Taylor 2.

```
. xtaylor groeth_rate fconsmp_coef gov_expendgdp subs_and_transf gini_coef corrup_index
public_rev~p cod, endog ( groeth_rate gini_coef)
```

```
Hausman-Taylor estimation      Number of obs   =      86
Group variable: cod           Number of groups =      9
```

```
Obs per group:
      min =      6
      avg =     9.6
      max =     10
```

```
Random effects u_i ~ i.i.d.      Wald chi2(7)    =     47.43
                                Prob > chi2       =     0.0000
```

```
-----+-----
groeth_rate |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|    [95% Conf. Interval]
-----+-----
TVexogenous |
fconsmp_coef |   .0367128   .2280964     0.16   0.872   - .4103479   .4837734
gov_expend~p |  -1.425911   .376739    -3.78   0.000   -2.164306   -.6875165
subs_and_t~f |  -0.1898642  .0895824    -2.12   0.034   -0.3654424  -.0142859
corrup_index |  -0.1452039  .0616088    -2.36   0.018   -0.265955   -.0244529
public_rev~p |  -0.1692095  .2046677    -0.83   0.408   -0.5703508  .2319318
TVendogenous |
gini_coef |  -0.5134185  .1591164    -3.23   0.001   -0.8252808  -.2015561
TIexogenous |
cod |  -1.130593   .985509    -1.15   0.251   -3.062155   .8009689
|
_cons |   85.05302  20.31614     4.19   0.000   45.23412   124.8719
-----+-----
sigma_u |   4.4136752
sigma_e |   2.9131065
rho |   .69656113 (fraction of variance due to u_i)
```